



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 KORRIK 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. JULA 2015. GODINE**

**KORRIK - JULI
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armë,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o autorskim pravima i srodnim pravima,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o oružju,
5. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-246 o opremanju oružjem, municijom i odgovarajućom opremom bezbednosti za Ovlašćene državne institucije za bezbednost,
6. Razmatranje godišnjeg izveštaja Centralne izborne komisije za 2014. godinu.

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare .

1. Koha është e deklarimeve jashtë rendit të ditës

Rregullat i dimë të gjithë. Fillojmë me zonjën Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë të paktit që qenkemi në salla,

Sot unë kam një temë të cilën kisha dashtë ta trajtoj edhe më herët ose të bëjë pyetje parlamentare pasi nuk arrita që të shtroj pyetje, pra ka të bëjë me trajtimin punëtorëve në sektorin privat në Kosovë në veçanti gjatë periudhës së verës kur punëtorët në pozita të ndryshme në sektorin privat punojnë edhe mbi 12 orë pa pushim dhe kjo punë nuk u kompensohet me asnjë cent.

Punëtorët që punojnë në supermarketet e ndryshme në Kosovë gjatë periudhës së verës por edhe kamerierët në lokalet e shumta në Kosovë kanë vetëm një ditë pushim në dy javë dhe ditët tjera punojnë me një orar i cili zgjatë deri në mesnatë.

Unë mund të kuptoj dëshirat e pronarëve që të shfrytëzojnë çdo minutë pune posaçërisht në këto ditë kur kemi frekuentimin e madh të bashkatdhetarëve tanë por s'mund të kuptoj pambarimisht mos respektimin e të drejtave të punëtorëve në vendin e tyre të punës.

Sigurisht që nuk dua të përgjithësoj të gjithë pronarët në sektorin privat, sepse ka edhe nga ata që në këtë drejtim respektojnë shumë mirë ligjet që derivojnë në këtë sferë. Mirëpo kam hasur mbi dhjetëra raste në më shumë se 5-6 vende të tilla ku punëtorë të punësuar në sektorin privat trajtohen jo si punëtorë, por fatkeqësisht edhe si skllevër.

Në këtë Kuvend i kemi miratuar disa ligje që mbrojnë të drejtat e punëtorëve por si duket ende kemi punë në zbatimin e tyre. Edhe më vështirë kur Inspektorati i Punës ankohet se ka pak inspektor në gjithë tregun e Kosovës që mund të mbulojnë terrene për këtë çështje.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk arrita të shtroj pra këtë në formë të pyetjes parlamentare por do ftoj nga kjo foltore ministrat përkatës që të bëjnë një aktivitet shtesë në këto ditë vere dhe të shohin edhe vetë nga afër se çfarë po ndodh, sepse nuk mjafton që ne si politikë bërës të bëjmë një ligj në letër dhe ai të mos ndihmoj asgjë në jetën e qytetarit tonë.

Në vendin tonë llogariten se në sektorin privat punojnë mbi 220 mijë persona me një pagë mesatare prej 220 euro në muaj edhe pse ky sektor konsiderohet si promotor i zhvillimit ekonomik në Kosovë, përfaqësues të punëtorëve thonë se aty shkelen më së shumti të drejtat e punëtorëve. Por, se ata heshtin për diskriminimet për shkak të vështirësive për të gjetur një punë tjetër.

Punëtorët në këtë sektor punojnë me orar të stërzgatur, pa kontratë pune, me vonesa të pagave, pa pagesë të kontributeve dhe në shumicën e rasteve me vetëm një ditë pushim në javë dhe pa mjete të sigurisë, e tani verës edhe vetëm me një ditë pushim në dy javë.

Duke parë këtë gjendje të vështirë jam interesuar dhe kam marrë informacion të saktë që në Kosovë ka kompani që paguajnë punëtorët me vetëm 120 euro në muaj e me këtë shumë punëtorë duhet të paguajnë ushqimin dhe udhëtimin.

Ftoj ministrin e Punës por edhe të Punëve të brendshme që të bashkëpunojnë qoftë edhe memorandume bashkëpunimi në drejtim të një dedektimi të këtij realiteti sepse kjo verë do të jetë edhe më e gjatë se vitet tjera e këta punëtorë s'do ta përballojnë lehtë një punë me orar të stërzgatur e me pushim një ditë në dy javë.

Pronarët e sektorit privat le të kenë kujdes në këtë çështje sepse ndryshe nuk do të ketë as zhvillim në këtë drejtim se dekurajomi dhe motivimi nuk qojnë në zhvillim të organizatave të tyre. Por duke mos harruar se kjo çështje prek edhe anën humane të njeriut. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit,

Të respektuar kolegë deputetë,

Të respektuar ministra, s'paska ardhur asnjë,

Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,

Arsye pse dola ta marrë fjalën është shqetësimi i qindra mësimdhënësve të Kosovës anë e këndë për problemet që na janë shfaqur si pasojë e udhëzimit ose urdhrit administrativ numër 06/2015 të nxjerrë nga Ministria e Arsimit, i cili ka të bëjë me normativin për përzgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha nivelet e arsimit para universitar të cilin udhëzim administrativ e ka nënshkruar ministri i Arsimit më 10 korrik 2015.

Ky udhëzim administrativ realisht është njëri prej udhëzimeve administrative i cili vërtetë do të paraqet probleme relativisht të mëdha për të gjithë mësimdhënësit të cilët ndodhen në procesin e mësimdhënës në tërë territorin e Kosovës për këtë arsye.

Zoti ministër,

Nga ju kërkojmë që udhëzimi administrativ numër 06/2015 të shfuqizohet dhe të mbetet në fuqi urdhri administrativ paraparak, i cili është shfuqizuar nga ky i fundit.

Sigurisht zoti ministër, mund të mos jeni të informuar por nga ministrat paraparak ndoshta me qëllim të mirë të tyre pa dashje janë shkaktuar shumë anomali në sistemin arsimor. Këtu një rol të veçantë e ka edhe Agjencia Kosovare e Akreditimit, Agjencia Kosovare për Akreditim ende nuk i ka licencuar drejtimet siç është rasti matematikë, informatikë, teknologji informatikë, kimi biologji, kimi fizikë, gjeografi edukatë qytetare e kështu me radhë edhe pse studimet në këto drejtime kanë vazhduar pandërprerë edhe tash këta të diplomuar pa ofenduar asnjë prej tyre shpërblehen së fundit edhe me këtë udhëzim administrativ numër 06/2015.

Ky urdhër i ka befasuar po thuaj se të gjithë mësimdhënësit në tërë territorin e Kosovës, vetë ata të cilët në konkurse që janë hapur në gjithë Kosovën me anë të gjykatave, duke u bazuar në këtë urdhër, do të fitojnë çdo kontest, e në këtë mënyrë bëhet një diskriminim i tmerrshëm ndaj këtyre mësimdhënësve.

Zoti ministër,

Udhëzimi administrativ numër 06/2015 bie në kundërshtim edhe me vetveten, shih nenet 11,12,dhe 13 dhe me udhëzime tjera si ai për licencimin e mësimdhënësve dhe të tjerë.

Siç dimë Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës ka qenë vazhdimësi e Shkollave të Larta Pedagogjike. Askush në rajon as në Evropë nuk kishte një fakultet të tillë që ofron programe siç janë matematikë-informatikë, gjuhë shqipe e kështu me radhë, duke bërë paralelizma me Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore dhe fakultete tjera duke afruar programe me emër të njëjtë dhe me përmbajtje skajshmërisht të dallueshme.

Për shembull drejtimi matematikë-informatikë në Fakultetin e Edukimit 40% e plan-programit e kishte nga matematika, 40% nga informatika, ndërsa vetëm 20% nga lëndët pedagogjike.

Po njëkohësisht edhe programet tjera siç është për shembull gjeografia 36%, edukatë qytetare 34,5%, metodikë 29,5%.

Zoti ministër,

Nga ministrat paraprak nuk pat kujdes as kontroll dhe vëzhgim ndaj punës së drejtorive komunale të arsimit siç dihet nëpër shumë komuna procesi i licencimit të mësimdhënësve është bërë në kundërshtim me rregulloret dhe udhëzimet administrative dhe ligjet përkatëse.

Nuk e di se si janë të rregulluara këto raporte mes ligjeve, rregulloreve e urdhrave administrativ të tuaj.

Janë licencuar mësimdhënës që nuk është dashur të licencohen, kjo tash bartë pasojat e veta. Madje keqpërdorimet dhe shkeljet janë bërë edhe në procesin e avancimit të kuadrove. Sipas urdhrat administrativ që ka të bëjë me avancimin e mësimdhënësve, programet AKM, të MASHT-it këto programe është dashur t'i vazhdojnë vetëm edhe vetëm ata mësimdhënës të cilët kanë mbaruar shkollën e lartë Pedagogjike dhe janë në marrëdhënie të rregullt të punës. Mirëpo, realisht në praktikë nuk ka ndodhur një gjë e tillë për arsye se pa të keqe dhe pa dashtë për me e ofendua askënd këtu në këto programe janë avancuar dhe janë futë edhe policët të cilët kanë mbaruar shkollat e larta pedagogjike por ndoshta edhe njerëz të cilët janë krejt jashtë profesioneve arsimore të cilët kanë punua nëpër profesione të ndryshme.

Që nga viti akademik 2012/2013 sipas Agjencisë Kosovare të Akreditimit në shumicën e universiteteve studimet zgjasin në formatin 3-2, domethënë tre vjet bachelloor dhe dy vjet master.

Në këtë aspekt, në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore, po ashtu në të gjitha drejtimit e profileve arsimore janë kthyer dhe zbatohet po ky program, si dhe në drejtime tjera përkatëse të Fakultetit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, vazhdoja deputetit fjalën!

SHPEJTIM BULLIQI: Përkatësisht ka nxjerrë mësimdhënës. Sipas Agjencisë Kosovare të Akreditimit studentë në këto drejtime bazën profesionale e marrin studimet bachelor FSHMN, prandaj, u përcaktohet për mësimdhënie. Licenca do të marrin në Fakultetin e Edukimit duke plotësuar edhe dy vite në pjesën e lëndëve pedagogjike.

Madje sipas Agjencisë Kosovare të Akreditimit edhe studimet master do të ketë programe të veçanta për ata që përcaktohen të punojnë në shkollat e mesme të ulëta dhe atë duke ju mundësua që faktikisht të gjithë këta mësimdhënës në një farë forme të ju krijohet mundësia të punojnë edhe në shkolla të mesme të larta.

Sigurisht që në qoftë se i marrim edhe i analizojmë të gjitha këto probleme të cilat i ka shkaktua ky udhëzim administrativ që është nxjerr tash së fundit nga ana e Ministrisë së Arsimit në terren do të paraqiten probleme të jashtëzakonshme për arsye se faktikisht neve po japim përparësi mësimdhënësve të cilët kanë një bazë shumë të ulët nga përgatitja e tyre profesionale dhe faktikisht fakultetet amë ose fakultetet bazë ku faktikisht kanë marrë bazën e përgatitjes profesionale të këtyre në një farë mënyre në të gjitha nenet e këtij udhëzimi administrativ po anashkalohen.

Për mos me ardhur deri te të gjitha këto probleme sepse besoj që këto probleme tash e tutje do të thellohen edhe më tutje dhe të gjitha këto do të adresohen në Ministrinë e Arsimit.

Unë kërkoj që ky udhëzim administrativ të shfuqizohet sa më parë.

2. Urdhri administrativ paraprak të riformulohet dhe të jetë shumë preciz në mënyrë që të mos ketë dykuptimësi dhe hapësirë për shumë interpretime në atë.

2.1. Në shkollat e mesme të larta të kualifikuara dhe të licencuara të konsiderohen vetëm ata të cilët studimet themelore bachelor profili arsimor i kanë përfunduar në Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore në lëndët ekzakte siç është matematike, fizika, kimia, biologjia dhe gjeografia. Për lëndët gjuhësore në Fakultetin e Filologjisë, për lëndët shoqërore në Fakultetin Filozofik.

2.2. Grada master të merret në konsideratë vetëm për ata të cilët studimet themelore bachelor i kanë përfunduar në fakultetet të cilat i përmendëm në pikën 2.1 dhe grada master të merr parasysh vetëm nëse studimet master kanë qenë vazhdimësi e studimeve themelore bachelor.

3. Studimet master për licencim në mësimdhënie që së shpejti do të fillojnë në Fakultetin e Edukimit të kenë të drejtë të vazhdojnë vetëm ata të cilët studimet bachelor i kanë mbaruar në fakultetet që i përmendëm në pikën 2.2.

Atëherë kur të vijë gjenerata e parë e të diplomuarve master në fakultetin e Edukimit ata të konsiderohen me prioritet për mësimdhënie dhe atë sipas programit për shkollat e mesme të ulët dhe sipas programit për shkollat e mesme të larta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Visar Ymeri e ka fjalën në emër të grupit parlamentar.

VISAR YMERI: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Gjatë vitit 2014, Kosovës iu u shtua, siç e keni parë në raportin e BQK-së edhe një bankë, kjo është Ziraat Banka nga Turqia, e cila u licencua në Kosovë si degë e bankës që operon në Turqi.

Mbase ia vlen të theksohet se Ziraat në Turqi ishte do të thotë bujqësi, pra është një agrobankë, por edhe më me rëndësi mendoj se Ziraat është me kapital shtetëror.

Kjo është banka e tretë që operon në tregun e Kosovës e që është e pronësuar nga shteti, tërësisht është ose pjesërisht. Dy tjerat janë NLB Prishtina nga Sllovenia si dhe “Komercijalna banka” nga Serbia.

Tipike pra për ekonominë e qeverive të deritashme por edhe të kësaj aktuale të Kosovës. Cilëndo nevojë që ta kemi, ne e importojmë.

Ekonomia e Kosovës natyrisht që ka nevojë për një bankë publike por ato po i marrim nga shtetet tjera. kështu nevoja jonë po shndërrohet në pasurim për tjetrin dhe kjo epo e prolongon nevojën tonë duke mos e përmbushur dhe po e rritë vazhdimisht pasurimin e tjetrit gjë që nuk përmbushet dot.

Ekonomia nuk zhvillohet kështu, kështu vetëm po pasurohen personat e caktuar në këtë rast Banka Komerciale profiti i të cilave për çdo vit shkon duke u rritur në përpjesëtim të zhdrejtë me rritjen ekonomike të Kosovës dhe në përpjesëtim të zhdrejtë po ashtu me varfërimin e popullit të Kosovës.

Sistemi bankar nuk vlerësohet vetëm në bazë të profitit që ai arrin ta ketë. Sistemi bankar më shumë duhet të vlerësohet në bazë të shkallës së kreditimit për ekonominë që ai e krijon. Roli primar i sistemit bankar duhet të jetë ndërmjetësimi në qarkullimin e parasë nga ata që kanë likuiditet tepriçë në një kohë të caktuar tek ata që kanë mungesë likuiditeti operacional stimulimit të konsumit ose për financimin e projekteve investive.

Në alternativën qeverisëse të Lëvizjes “Vetëvendosje” ne e kemi paraparë themelimin e dy fondeve të veçanta për investime në prodhimin vendor: fondi për bujqësi dhe në anën tjetër fondi investiv për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në afat të mesëm këto dy fonde do të shndërroheshin në bankë për zhvillim dhe eksport. Kjo bankë do të jetë e themeluar në bashkëpunim me sektorin privat ku pronësinë vendimmarrëse do ta mbajë shteti, por menaxhimi do të bëhet në bazë të parimeve të tregut dhe konkurrencës së lirë në treg. Mërgatës sonë do t'i ofrohet që paratë e tyre, të cilat nuk dëshirojnë t'i investojnë drejtpërdrejtë në prodhim ti kanalizojnë në ekonominë e vendit përmes bankës për zhvillim dhe eksport.

Kjo bankë do të ofrojë kredi të ulëta për bujqësinë, për zgjerimin e sipërmarrjes, për eksport dhe për aktivitete tjera investive që krijojnë vende të punës dhe e rritin ekonominë në përgjithësi. Ajo do të shërbejë po ashtu si bankë për financimin e investimeve të mëdha dhe afatgjate në sektorin publik, në KEK për shembull, në Trepçë, në PTK dhe tjera dhe në sektorë tjerë të prodhimit që kanë rëndësi strategjike për ekonominë e Republikës së Kosovës. Kjo bankë po ashtu me ndërhyrjen e vetë në treg do të krijonte njëmend konkurrencë të mirëfilltë që do të rezultonte në uljen e dallimit në mes të kamatave në depozita dhe kamatave në kredi gjë që është dallimi që e krijon profitin e bankave, i cili përkundër lëvizjes së normave të kamatave në këto dy shërbime bankare asnjëherë nuk ndryshon në madhësinë e tij.

Pra, ky është profiti që po e realizojnë bankat dhe kjo marzhë është ajo që po varfëron popullin e Kosovës i cili është vendosur kryekëput nën varësinë e këtyre bankave komerciale të cilat po e varfërojnë ekonominë tonë duke mos i kthyer gati se asgjë asaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit! Nuk jam në emër të Grupit, Teuta Haxhiu do të jetë në emër të grupit, por pasi e mora fjalën në rregull është.

Unë nuk po dua të flas sot as për mungesën e planifikimit të furnizimit me energji elektrike, as s'po dua ta përmend privatizimin e dëmshëm që ka ndodh me KEDS, as nuk po dua të flas pse po i refuzoni kompanitë e perëndimit, në këtë rast kompanitë gjermane dhe asnjë temë që lidhet me afëra të shumta në sektorin energjetik në vend deri te mungesa e çfarëdo vullneti politik për t'i ndërtuar kapacitetet e reja energjetike. Por, veç po dua ta pyes kryeministrin e vendit pasi erdh a e din që në 80% të komunave të Kosovës në këtë javë në këto temperatura kaq të larta deri në 10 orë në ditë nuk ka as rrymë, as ujë? Më së pakti 10 orë në ditë nuk ka unë mundem t'i numëroj komunat, një nga një, ku njerëzit nuk kanë furnizimin me rrymë dhe nuk kanë ujë.

Edhe si Qeveri a e keni ndërmarrë veprim për ta sanuar këtë gjendje, a e keni thirrur dikë në përgjegjësi? A munden qytetarët të presin që do të përmirësohet kjo gjendje se kështu si e keni lënë po krijohet përshtypja si me qenë situatë e jashtëzakonshme. Se në situata normale ku një shtet ka një Qeveri për një javë në temperatura 40 gradë nuk lihen qytetarët pa rrymë dhe pa ujë.

Kryeministër pasi jeni këtu ndoshta ka qenë mirë të na tregoni cilat veprime i keni ndërmarrë dhe çka po bëni në këtë drejtim?

KRYETARI: Donikë duhet t'ia shtroni pyetje parlamentare. Qe kryeministri për gjendje të jashtëzakonshme. Valdete, Shukrije. Valdete, në emër të grupit, a po? Valdete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar "Nisma", e ka fjalën.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Gjendja e rëndë politike në vendin tonë si dhe mos funksionimi i ekzekutivit po i jep efekte negative në jetën gjithë qytetarëve duke përfshirë këtu gjendjen e rëndë sociale të një numri shumë të madh të qytetarëve tanë. Në këtë gjendje nuk janë vetëm familjet të cilat kanë një të ardhur minimale, por po janë ato familje të cilat nuk kanë të ardhura fare e që do të duhej që shteti të kujdesej për to, familje të cilat kanë anëtarë të familjes me të meta fizike, me sëmundje të rënda dhe që nuk po gjejnë mbështetje në institucionet gjegjëse.

Shtrohet pyetja se çka është duke bërë shteti për qytetarët e vetë. Deri në ditët e sotme krejt çka kemi dëgjuar nga Qeveria në fillim të qeverisjes së saj ishte kërkesa t'iu japim kohë sa të kalojë 100-ditëshi, pastaj u tha që Qeveria nuk paska shkop magjik për të krijuar vende të punës ashtu siç ishte premtuar gjatë fushatës.

Ditët, muajt po kalojnë dhe asnjë pikë ndryshimi apo përmirësimi nuk po e bën kjo Qeveri për jetën dhe mirëqenien e qytetarëve të saj. Sot dua të ndalem pak te çështja e shërbimeve sociale që nuk po është fare në dispozicion të familjeve në nevojë dhe këtu pat thënë që shumë qytetarë po e keqpërdorin këtë shërbim social. Po ju a nuk po e keqpërdorni gjithë buxhetin e shtetit duke mos kursyer as asistencë sociale dhe po i akuzoni familjarët në nevojë që po marrin një shumë kaq të ultë ju lutem. Çka është duke ndodhur me këtë shërbim? Kohët e fundit është paraqitur problemi i bllokimit të llogarive zyrtare të MP-së, MS-së që janë të dedikuara për shfrytëzuesit e ndihmës sociale e që kjo po ua merr edhe bukën e gojës pikërisht këtyre familjeve.

Përmbaruesit privat në disa regjione në territorin e gjykatave themelore caktojnë përmbarimin dhe bllokojnë llogarinë e shfrytëzuesve të ndihmave sociale e cila llogari është nën menaxhimin e DPSF-së dhe është krijuar me bankën e caktuar vetëm për një qëllim të qarkullimit të mjeteve nga ndihma sociale. Pra, nuk është llogari rrjedhëse e zakonshme personale në emër të borxhit që shfrytëzuesi i ndihmës sociale e ka ndaj një kompanie apo qoftë edhe ndaj ndonjë personi privat.

Ky veprim, të nderuar qytetarë, është antikushtetues kundër të drejtës së njeriut për ushqim dhe kundër çdo konvente ndërkombëtare për të drejtën e njeriut dhe për çështje sociale . sepse, mjetet e ndihmës sociale nuk janë pagë ato janë të ardhura apo të fituara nga puna e bartësit të familjes por janë mjete të siguruara nga shteti për një familje në nevojë dhe për ushqim dhe mbijetesë.

Ju bëj thirrje Qeverisë që të mos i prekin këto llogari të qytetarëve, të cilët të vetmin burim e kanë këtë ndihmë sociale edhe pse është shumë e vogël. Dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të ju merren ato pak para që dedikohen pikërisht për këto familje. Në këtë drejtim sipas gjendjes faktike në terren nuk kanë ndërmarrë asnjë hap të vetëm që të eliminohet kjo shkelje e të drejtave ligjore që u bëhet shfrytëzuesve të ndihmës sociale. Andaj, nuk presim ndoshta edhe nga kjo Qeveri që të reflektojë pasi që rahatënë ia ka bërë sigurisht militantëve të saj partiak e sa për popull dertin kush nuk e ka.

E vetmja ndihmë që po ju ofrohet qytetarëve në nevojë për ekzistencë po janë atdhetarët tanë nga diaspora ku në formë të ndryshme po i ndihmojnë familjet në nevojë e ku besa kontributi tyre shkon deri në atë pikë sa edhe bëjnë ndërtimin e shumë shtëpive pikërisht për këto familje. Ditë më parë kryeministri i vendit tha se ne nuk mundemi për 8 muaj që të bëjmë hapjen e 150 mijë vendeve të punës ose 200 mijë siç ishte deklaruar nga partneri i tij. Kryeministër deri më sot të vetmit, të cilët kanë gjetur punësim janë pikërisht militantë tuaj dhe atij të PDK-së.

Kjo tallje e Qeverisë dhe e dy partive në koalicion e bërë gjatë fushatës për krijimin e vendeve të punës me të vërtetë qon deri në atë pikë sa që edhe qytetarët edhe ne si opozitë jemi të vetëdijshëm që ajo nuk realizohet, por së paku të jeni të përgjegjshëm t'i keni parasysh rastet sociale dhe të merreni me ta dhe mos t'i keni vetëm në fokus njerëzit e juaj të partive. Faleminderit!

KRYETARI: Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Sot në këtë seancë dua të flas për një shqetësim të qytetarëve, por edhe tonin që ka të bëjë me aksidentet e shumta në komunikacion që po raportohen çdo ditë nëpër media tona. Çdo ditë raportohet për aksidente që ndodhin në rrugët tona ku përveç lëndimeve dhe dëmeve materiale numri i atyre që humbin jetën në trafik është shumë shqetësuese.

Mund të mendohet që aksidentet e tilla ndodhin në gjithë botën, kjo është e vërtetë, mirëpo nëse e shikojmë numrin e aksidenteve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë shifrat në Kosovë janë alarmante. Pyetja që shtrohet këtu është ku qëndron problemi? Cilët faktorë luajnë rol dhe kush është përgjegjës për këto aksidente? Për një gjendje të tillë nëpër rrugët e Kosovës rol luajnë shumë faktorë. Faktorët e pa menaxhuar fatmirësisht janë të paktë, në bazë të statistikave faktori kryesor për këtë situatë është i menaxhuar dhe i mënjanuar prandaj është shumë urgjente që të ndërhyhet për të ndryshuar për të mirë në këtë drejtim. Gjithmonë duke iu referuar statistikave dhe raporteve zyrtare të policisë këtu kemi të bëjmë kryesisht me faktorë siç janë: pajisjet me patentë shoferë, mosprania e mjaftueshme e policisë së trafikut, gjendja e rrugëve dhe kushtet atmosferike.

Në këtë listë me një epërsi të lartë prin faktori njeri, sidomos në rastet e aksidenteve me pasoja fatale. Një pasqyrë e shkurtë shihet kështu, në vitin 2013 numri i përgjithshëm i aksidenteve në Kosovë ishte 19 954, prej tyre me fatalitet 104 aksidente me 119 të vdekur dhe të lënduar 9 mijë e 817 persona. Në vitin 2014 numri i përgjithshëm ishte 16 300 me fatalitet 111 aksidente, të vdekur 127 persona, të lënduar 9 713. Krahasuar me dy vitet paraprake në vitin 2015 edhe pse jemi vetëm në muajin e 7 të vitit numri i përgjithshëm i aksidenteve është 7 376. Me fatalitet 41, të vdekur 46, të lënduar 4 207.

Sipas kësaj del se për 3 vjet kemi humbur 276 qytetarë, e të mos flasim për numrin e atyre që mbetën me pasoja dhe lëndime. Këto shifra janë zyrtare dhe janë të marra nga Policia e Kosovës. Çka mund dhe çka duhet të bëjmë që këto statistika t'i ndryshojmë për të mirë? Hapat që duhet të ndërmerren janë: monitorimi dhe plotësim ndryshimi i Ligjit për patentë shoferë, ngritja e kriterëve për këtë dhe kontrolli i rreptë ndaj keqpërdorimeve në këtë drejtim, kontrolli i shtuar i policisë së trafikut, dënimet përveç në të holla duhet të përfshin edhe sanksionet me pikë në sistem dhe në raste përsëritjesh tërheqja e patentë shoferit. Kontrolli në përmirësimi i rrugës, mirëmbajtja më e mirë në stinët e dimrit, gjithashtu mendoj se si Kuvend komisioni përkatës duhet ta bëjë edhe monitorimin dhe rishqyrtimit të Ligjit për siguri në komunikacion.

Duke iu shprehur ngushëllime të gjithë atyre që humbën më të dashurit e tyre në komunikacion kërkoj nga institucionet përgjegjëse që të shtojnë kontrollin në rrugët tona dhe thjeshtë këto aksidente të jenë sa më të pakta dhe mundësisht të evitohen në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Armend apo Sali cili jeni? Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kryetar i Kuvendit,

Para pak kohësh kërkoja këtu nga ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të shikuar gjendjen e pyjeve të Komunës së Deçanit e cila përfshin pjesën më të madhe që janë më masive në Bjeshkë të Nemuna.

Përpos degradimit të vazhdueshëm të kësaj pjese të natyrës, qytetarët e Deçanit vazhdimisht kanë ngritur zërin si ndaj pushtetit lokal por edhe atij me kompetencë qendror për gjendjen e krijuar viteve të fundit dhe e cila asnjëherë nuk ka të ndalur. Që nga fillimi i punimeve për ndërtimin e tri hidrocentraleve të cilat ishin proklamuar si investim që do të sjell përfitim në favor të interesave të qytetarëve të kësaj treve por që shihet tanimë që është interes i caktuar i grupeve të caktuara dhe individëve, përpos degradimit të shtratit të lumit Lumbardh, duke e larguar masën drunore përgjatë këtij lumi, duke krijuar zonë erozive nga shtrati i këtij ka bërë që të sjell edhe mungesë të ujit të pijes duke bërë që shtrati i lumit e sidomos tash verës të mbetet i shkretë.

Në këto ditë të nxehta verore komuna e Deçanit në përgjithësi si pjesa e qytetit por edhe shumë fshatra të saj po ballafaqohen tash e sa ditë me mungesë të madhe të ujit me reduktime të mëdha, të paplanifikuara të cilat po shkaktojnë probleme të mëdha qofshin ato higjienike dhe qofshin ato psikike. Pjesa më e madhe e qytetit të Deçanit dhe shumë fshatra si: Prapaçan, Dubovik, Papiq, fshatrat e rajonit të Vokshit edhe pse këtu kishim të riparuar një ujësjellës për 10 fshatra i cili momentalisht gjendet duke u hetuar edhe në prokurori tregon qartë keqpërdorimin dhe gjendjen e krijuar për mos pasje të ujit në këtë trevë e cila është e njohur për ujë të bollshëm. Ky shqetësim nuk është zoti ministër, sidomos kjo vlen edhe për Kabinetin qeveritar, por edhe pjesën lokale sepse janë proklamuar investime të përvjetshme, por siç shihet kjo nuk është prioritet, që uji i pijes të jetë i furnizuar për të gjithë qytetarët e kësaj treve.

Andaj, edhe sot, pa dashur që të kem interferim në gjendjen e natyrës në të nxehtë që është, kjo ndodh jo vetëm gjatë verës, pse tash është e shtuar, kjo ndodh edhe në kushtet dimërore, kur qytetarët e komunës së Deçanit, pjesë-pjesë nuk kanë fare ujë të pijes dhe të cilët në mënyrat e veta po ballafaqohen për furnizim, i cili nuk është aspak higjienik dhe shëndetësor.

Andaj, e ngreha këtë çështje, e cila është shumë serioze...

KRYETARI: E ka fjalën Glauk Konjufca, nga “Vetëvendosje”.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Më 19 janar, Qeveria e Republikës së Kosovës e pat sjell në Kuvend të vetmin ligj të mirë, që e ka sjell kjo Qeveri prej kur e ka marrë mandatin dhe, ky ka qenë ai ligji i famshëm për

“Trepçën”, ku në pikën e tretë e definonte “Trepçën” edhe si kompani publike, por në të njëjtën ditë ky ligj u pat tërhequr dhe kjo i pat shtyrë minatorët e “Trepçës”, që të futen në një grevë urie dhe ia patën dërguar një letër kryeministrit Isa Mustafa.

Në pikën e fundit të kësaj letre, që ia patën drejtuar minatorët, shkruan kështu, unë po e lexoj pikën e fundit: “Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta zgjidhë brenda afatit 5-mujor statusin e ndërmarrjes “Trepça”. Nëse nuk definohet statusi i “Trepçës” në afatin 5-mujor atëherë greva rifillon dhe ndërpriten të gjitha kontaktet me institucionet dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës, mirëpo besojmë se deri te kjo nuk do të vijë, pasi që institucionet e Kosovës do t’i kryejnë obligimet e tyre. Në një rast të tillë gjendja mund të eskalojë dhe përgjegjësitë i mbajnë institucionet e Republikës së Kosovës.”

Pas tërheqjes së atij ligji, Qeveria deri në prill nuk e pati sjellë ligjin tjetër, mirëpo i cili sërish i shmanget asaj temës kryesore sa i përket statusit të “Trepçës”. Qeveria pat bërë premtime publike, se brenda 5 muajsh do ta sjellë një strategji dhe një ligj, me të cilin do të rregullohej ky kombinati “Trepça” dhe nuk e ka mbajtur premtimin, sepse jemi një muaj prej kur kanë kaluar ato pesë muaj që i janë dhënë afat Qeverisë së Republikës së Kosovës nga ana e minatorëve të “Trepçës”. Dhe, kjo është shumë joserioze, është papërgjegjësi totale, është mos mbajtje e premtimeve dhe, në njërën nga mbledhjet e tashme të Qeverisë së Kosovës, ata kanë paralajmëruar se Ligji për “Trepçën”, as strategjia nuk do të sillet deri në vitin e ardhshëm.

Çfarë është edhe më shqetësuese, në një prononcim publik zëdhënësi i Qeverisë, kur e kanë pyetur për “Trepçën” shprehet kështu: “Kemi pasur takime konsultative me kompani kanadeze dhe gjermane në fushën e industrisë minerare, për të përcaktuar orientimet tona lidhur me “Trepçën””.

Më falni, por kjo deklaratë, kjo qasje është shumë shqetësuese, duhet të jetë shqetësuese për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Çka do të thotë kjo? Qeveria mendon që për orientimet e veta, sa i përket ekonomisë, “Trepçës” e zhvillimit të Kosovës, duhet për t’u pyetur kompanitë private kanadeze dhe gjermane. Kjo është skandaloze, më falni. Qysh mund të shprehet një zyrtar i Qeverisë kështu?

Po ti t’i pyesësh kompanitë private çfarë mendojnë ato për “Trepçën”, ato natyrisht që kanë për të thënë: “a ka mundësi me na i shitë sa më shpejt edhe sa më lirë”, ashtu qysh janë bërë “rrush e kumbulla” krejt këto asetet e Kosovës.

Qeveria nuk funksionon duke i pyetur kompanitë private për pasuritë tona. Një qeveri serioze më së pari e ka orientimin e vet, se çka i duhet Kosovës, cili është plani më adekuat dhe, ky është plan nacional, një debat shoqëror edhe këtu në Kuvendin e Kosovës dhe kështu përcaktohen orientimet dhe ajo çka na duhet më së shumti, e jo duke i pyetur kompanitë private se çka mendojnë ato, çka duhet të bëjmë me “Trepçën”. Kjo është skandaloze.

KRYETARI: Faleminderit! Me lejen tuaj, koha ka mbaruar. A dëshironi nga dy minuta për t’u dhënë, janë edhe shtatë diskutues, apo ta mbarojmë. Shefat e grupeve parlamentare po i shoh se janë për jo. Teutë, për besë ka reagim, se me qejf të shtatëve do t’ua lejoja të flisni.

E vazhdojmë edhe dhjetë minuta, tre vetë nga tre minuta. Teuta e ke fjalën, pastaj shkojmë edhe dy partitë tjera, PDK-ja s'e merr fjalën më. Nga tre minuta i keni, të lutem! OK, katër minuta edhe dy vende nga tre, strikt. Urdhëro, vazhdo!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Në sistemin arsimor parauniversitar të Kosovës ka një numër jo të vogël të shkollave të mesme të larta, të drejtimeve profesionale, të cilat janë hapur me vendim të Ministrisë. Gjithashtu, ekzistojnë edhe shkolla të mesme të larta të tjera, sipas drejtimeve janë të karakterit të përzier, në të cilat ka drejtime gjimnazi, siç janë drejtimi gjimnaz i shkencave natyrore, gjimnaz matematik informatikë, i shkencave shoqërore, i shkencave gjuhësore, e tjera, por, në këto shkolla hapen çdo vit drejtime profesionale, siç janë drejtimet: makineri, bujqësi, shkenca juridike, drejtime të shkencave teknike, hotelieri, turizëm e shumë të tjera.

Në fakt, arsimi i mesëm i lartë, rolin kryesor e ka në përgatitjen e nxënësve për studime universitare, në drejtimin e të cilëve ata kanë prirje me të madhe, por një numër jo i vogël i nxënësve të kësaj kategorie nuk arrijnë të kenë suksesin e mjaftueshëm për t'u bërë studentë. Për këtë arsye, ka qenë shumë e nevojshme, që këto shkolla profesionale, pra të ketë drejtime profesionale brenda gjimnazeve edhe në mënyrë që nxënësve të tillë t'u jepet mundësia që ata të përgatiten për profesionet e tyre që parapëlqejnë dhe të bëhen zotërues të atyre profesioneve.

Por në fakt, çfarë është duke ndodhur me shkollat tona profesionale. Në shkollat profesionale mungon baza themelore e të mësuarit dhe e të nxënësve të dijeve nga ana e nxënësve. Në këto shkolla nuk ka libër nga i cili duhet të mësojnë. Nxënësit tanë nuk kanë libra të drejtimeve profesionale, për shkak të mungesës së librave mësimdhënësit detyrohen t'u sigurojnë literaturë, qoftë na interneti edhe atë nëse mund ta gjejnë, qoftë duke u dhënë shënime nga kapituj të shkëputur nga librat universitar, të cilat edhe lodhin nxënësit, por edhe janë jo të përshtatshme për moshën e tyre. Në shumicën e këtyre shkollave nxënësit nuk kanë ku dhe si ta bëjnë apo ushtrojnë praktikën e tyre profesionale, sepse para se të hapen këto drejtime profesionale, gati në asnjërin prej këtyre drejtimeve nuk është bërë studim i mjaftueshëm nga ekspertë të këtyre lëmenjve, në mënyrë që ata të përgjigjen në pyetjen, ku dhe si ta realizojnë praktikën profesionale si pjesë e pandarë e plan-programeve të këtyre drejtimeve.

Si pasojë, në shkollat tona profesionale regjistrohen nxënësit më të dobët të mundshëm për nga suksesi që e kanë pasur në shkollimin fillor dhe duke mos pasur mundësi që t'i realizojnë synimet për një shkollim të duhur profesional. Mësimdhënësit tanë të drejtimeve profesionale, nuk e kanë dhe akoma nuk mund të gjejnë vullnetin e duhur, për t'i joshur nxënësit e mirë, që në shkollimin e mesëm të lartë të vijnë në ndonjërin prej drejtimeve profesionale.

Pra, janë këto tri arsye që ne si Aleancë mendojmë se në qoftë se nuk veprohet në këtë drejtim, atëherë shkollat tona profesionale do të mbeten të zbrazëta, pa nxënës, edhe pse janë dhënë milionë eurosh nga Ministria për t'i ndërtuar ato objekte.

Mendojmë gjithashtu, se para se të merren vendime për të ndërtuar shkollë profesionale apo për të hapur ndonjë drejtim të ri profesional në shkollat ekzistuese, duhet të bëhen analiza dhe studim i mirëfilltë edhe për kuadrin mësimor edhe për literaturën që duhet të përdoret edhe për mjetet konkretizuese apo laboratorët, që duhet ngritur për të realizuar praktikën profesionale.

Ne si Aleancë vlerësojmë gjithashtu se është më mirë që të njëjtat të planifikohen për hapjen e punëtorive profesionale, funksionalizimin e bizneseve të vogla profesionale, në mënyrë që edhe nxënësit të kenë mundësi të kryejnë pra praktikën e tyre profesionale, po ashtu edhe të hapen vende të reja të punës. Gjithashtu, rekomandojmë që në vend të investimeve miliona eurosh për ndërtime të objekteve të zbrazëta do të ishte më mirë, që Ministria t'i sigurojë secilit nxënës librin e tij në secilën lëndë mësimore të drejtimit profesional dhe pastaj të kërkohet cilësia në arsim të cilën aq shumë po e dëshirojmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Do të shkoj një nga pozita një nga opozita. Nuredini ose Salihu, le të vendosin, janë të LDK-së.

NUREDIN IBISHI: I nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Unë si deputet i ri i Kuvendit në legjislaturën e pestë ndjej nevojën, që në fund të sesionit pranveror të punës së Kuvendit të shpreh përshtypjet e mia lidhur me punën e deritashme të Kuvendit, komisioneve, administratës së Kuvendit, në marrëdhënie me jashtë, bashkëpunimi qytetar, shoqëri civile dhe mediat.

Duke përkujtuar fillimin sfidues deri te marrëveshja e tashme e koalicionit, e konstituimit të kësaj legjislature, betimit të deputetëve, zgjedhjen e organeve të Kuvendit dhe pauza e gjatë para fillimit të funksionalizimit dhe fillimit të Kuvendit të deputeteve në legjislaturën e pestë dhe kritikën e mediave për opinionet ndaj Kuvendit dhe deputetëve për paga të majme, jo të merituar, pra të punonjësve. Në këtë gjendje opinioni nuk ishte shumë i interesuar për rolin domethënës të deputetëve dhe të Kuvendit të Kosovës në funksion të një shteti me demokraci parlamentare.

Desha vetëm të rikujtoj për vendimin e deputetëve në legjislaturën e kaluar, kur ata hoqën dorë në rritjen e pagave dhe se përafërsisht paga bazë e deputetëve tash është gati një masë sa edhe zëvendësministrat dhe sekretarët permanentë.

Si deputet i ri dua të ngre shqetësimin tim lidhur me ngritjen e njohurive dhe kapaciteteve për deputetë në mandat të parë në këtë legjislaturë. Deputetët e kësaj legjislature filluan punën me një trajnim njëditor me shpërndarjen e doracakëve të punës në komisione, të organizuar nga NDI. Edhe atë po e përkujtoj se LDK-ja ishte 15 marsi i vitit 2015 dhe kjo ishte e tëra.

Nga shembujt e mirë të përkrahjes profesionale dhe marrëdhënies me qytetarët do të përmendja Parlamentin kroat, ku në kuadër të parlamentit kanë komisionin profesional dhe këshillin e qytetarëve, anëtarët e dy komisioneve parlamentare të cilat kanë të gjitha të drejtat, përveç të drejtën për votë. Kuvendi për momentin ka përkrahje minimale profesionale në ngritjen e kapaciteteve dhe se vetëm disa institucione ndërkombëtare edhe atë në afat të shkurtër ndihmojnë në mbështetje profesionale sikur se është UNDP, CDF, KFOS, OSBE-ja dhe DIKAF.

Ne nenin 74 të Kushtetutës ushtrimi i funksionit përmban që deputetët e Kuvendit të Kosovës ushtrojnë funksionin e tyre në interes më të mirë të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e procedurës së Kuvendit. Pra, unë parashtroj pyetjen se si mund të ushtroj unë një funksion të tillë, pa qenë i njoftuar dhe i pajisur me materiale dhe pajisje të duhura? A kemi ushtuar në mënyrë të denjë funksionet tona si deputet dhe Kuvend, duke filluar nga ai funksioni ligjvënës, planifikimi i ligjvënës dhe procesi i ligjvënies, mbikëqyrjes së ekzekutivit, mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve, mocioni për interpelancë, pyetje për qeveritarët, debate për parlamentare, mbikëqyrje e institucioneve të pavarura, marrëdhëniet dhe konsultat me publikun, marrëdhëniet me medie, e të tjerë.

Nëse lexohen raportet e mbikëqyrjes së Kuvendit, komisioneve dhe deputetëve nga institucionet e ndryshme vërehen më shumë të dhënat kuantitative se sa ato substanciale, kualitative dhe krahasuar sipas statistikave vjetore të legjislaturës, po pse jo edhe rezultate krahasimore të parlamenteve të shteteve tjera të rajonit, që janë pjesë e Bashkimit Evropian.

Rregullorja e Kuvendit e vitit 2010 ka nevojë për plotësim dhe ndryshim, dhe se tentativat për miratimin e rregullores së re nga legjislatura e kaluar kanë dështuar dhe disa herë kjo i përngjan legjendës për ndërtimin e “Urës së Shenjtë”.

Rregullorja në fuqi ka mangësi të mëdha, sidomos kur i referohet rregullave rreth të drejtave dhe detyrave të deputetëve. Shumë nga këto dispozita janë burokratike, autoritare, që pamundësojnë punën e mirëfilltë të deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Dhe krejt në fund, mungojnë ambientet e punës të deputetëve për punë veç e veç, si në nivel qendror po edhe në nivel lokal, pra nëpër komuna, edhe pse ato janë premtuar, ndërsa sesioni i komunave ende nuk ka marrë vendim që të hapet ndonjë zyrë apo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nuredin, më vjen keq... Faleminderit për paraqitjen e këtyre qëndrimeve! Dëgjo, tash kemi nga opozita. Shqipja nga opozita, Shqipja, Zafiri, Shaipi,... Zafir, a po bëhesh gjentëlmen, Shqipja le ta marrë fjalën. Shqipja dhe me kaq po e përfundojmë. Më vjen keq! Pastaj na mbesin edhe katër deputetë për herët tjera.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit shumë, kryetar!

Unë brenda një minute do të mundohem të ngre një shqetësim, që besoj është i gjithë këtij Kuvendi. Të hënën që shkoi, më 20 qershor, Komisioni ad hoc ka bërë intervistimin e mbi 50 kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së dhe ajo çka ka ndodhur vërtet është jo vetëm e papranueshme, por besoj edhe e turpshme.

E para, nuk janë lejuar vëzhguesit dhe mediat që të monitorojnë procesin përkundër faktit që një gjë e tillë është e lejuar me Rregullore.

E dyta, mënyra e vlerësimit dhe kandidatët që janë rekomanduar për seancë, vërtet është më shumë se e papranueshme. Në mesin e kandidatëve ka pasur njerëz me kredibilitet të lartë, me autoritet të lartë të cilët kanë dhjetëra publikime, qoftë në fushën e mediave apo të tjera dhe

përkundër këtij fakti Komisioni dhe kryesisht koalicioni LDK-PDK, natyrisht me ndihmën edhe të minoriteteve, i ka rekomanduar këtij Kuvendi njerëz të cilët nuk i plotësonin as kriteret bazë, por vetëm se ishin militantë të devotshëm të partive politike, përfshirë këtu edhe kandidatë për deputetë.

Ne kemi diskutuar gjatë në këtë Kuvend për Radiotelevizionin e Kosovës, për problemet që i ka ky institucion dhe për më tepër jemi zotuar duke i miratuar rekomandimet unanimisht se ne marrim përgjegjësinë që këtij institucioni t'i kthejmë kredibilitetin dhe imazhin, por ajo çka bërë komisioni, në fakt e bëri të kundërtën.

Nëse ne vazhdojmë me këtë trend, ky institucion do të shkatërrohet dhe kësaj here përgjegjësia jo vetëm që i bie këtij Kuvendi në tërësi, por në veçanti LDK-së e cila u deklarua se dëshiron t'i kthejë imazhin dhe dëshiron t'i kthejë kredibilitetin këtij institucioni, por në fakt ajo çka ka bërë është që ka rekomanduar militantët e vet të cilët nuk u zgjodhën për deputetë nga qytetarët dhe këta vendosën që tani t'i rehatojnë nëpër borde ashtu sikur që duket se jeni marrë vesh brenda koalicionit.

Unë bëj thirrje që ky proces të anulohet dhe edhe një herë të shqyrtohet lista e kandidatëve dhe të rekomandohen njerëz që e meritojnë të jenë në këtë institucion. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ka përfunduar koha për deklaramë jashtë rendit të ditës. Xhevahire, më vjen keq, por do të jemi në seancë për këtë çështje dhe tani i kemi deklaratat e ministrave. Ministri i Arsimit e ka kërkuar fjalën. Ju lutem, të keni parasysh, deputetët kanë mundësi ta komentojnë deklaratën e ministrit. Faleminderit!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj t'i jap disa sqarime lidhur me shqetësimet e deputetit profesor Bulliqit të ngritura në fillim të kësaj seance.

Deputeti i ngriti disa shqetësime sa i përket normativit për mësimdhënës dhe më lejoni t'i jap përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme.

Fillimisht dëshiroj të theksoj se brenda përpjekjeve për ngritjen e cilësisë në arsim, për ngritjen e standardeve të cilësisë kemi identifikuar se ngritja e cilësisë mund të bëhet vetëm duke krijuar mësimdhënës të përgatitur. Nëse domi sukses në arsim, në shkolla investimin duhet ta bëjmë më të madhin tek arsimtarët, sepse vlerësoj se nxënësit janë më të hapur ndaj teknologjive të reja, ndaj njohurive të reja, kurse mësimdhënësit akoma janë pak konservatorë.

Për këtë arsye, në gjithë Bashkimin Evropian, por edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, politikat shtetërore ndaj mësimdhënësve janë politika të mbrojtura. Secili shtet serioz ka parasysh se kush mund të jetë mësimdhënës në atë shtet, sepse ai e edukon rininë dhe ai bëhet një partner me shtetin.

Duke u nisur nga kjo, prioritetin që e kanë mësimdhënësit e mirë, mësimdhënësit e përgatitur, të trajnuar, mësimdhënësit profesionalë po edhe pedagogjikë, ne jemi duke bërë një reformë të thellë me ndihmën e Bashkimit Evropian, me ndihmën e shteteve donatore që të krijojmë politika shtetërore për mësimdhënës. Kjo kërkon që brenda Fakultetit të Edukimit, i cili i ka 5 vite që sponzorohet tërësisht nga Bashkimi Evropian, nga Kanada dhe shtetet tjera, të krijojmë programe të mira të masterit që përgatisin mësimdhënës të mirë.

Profesor i nderuar,

Dëshiroj t'i heq shqetësimet, sepse ti vjen nga Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, po më duket nga Katedra e Biologjisë apo e Gjeografisë, nuk e di saktësisht.

Absolutisht asnjë fakultet, përfshirë Fakultetin e Shkencave dhe Filologjik, nuk do të pengohen që të ofrojnë studime të masterit në fushat lëndore, por, të gjithë studentët e shkencave matematiko-natyrore dhe filologjike që mendojnë të jenë mësimdhënës, kur të vijnë në master duhet të zgjedhin ose një master shkencor aplikativ ose një master pedagogjik. Nëse vendosin të investojnë në profesionin e mësimdhënësit, ata masterin duhet ta marrin te Fakulteti i Edukimit i cili është i specializuar për mësimdhënës dhe për të krijuar mësimdhënës.

Pra këto janë reforma evropiane për të cilat ne nuk do të zbrapsemi. Na e dimë se secila reformë shkakton pakënaqësi, shkakton edhe prishje të monopoleve në disa fakultete, por ne jemi të vendosur për të krijuar një arsim cilësor dhe për të krijuar arsim cilësor duhet të krijojmë mësimdhënës të përgatitur dhe askush nuk mund ta ndalë këtë proces sepse ia kemi borxh këtij vendi. Pas pavarësisë s'ka prioritet më të madh se për të krijuar një edukim të avancuar, një shëndetësi të mirë. Nuk mundemi ne gjithmonë të ushqejmë popullin me gjëra të mëdha të politikave.

Tani populli duhet të shijojë shërbime publike të mira në arsim, në shëndetësi dhe në fusha tjera dhe për këtë arsye kemi një plan strategjik për të cilin kemi siguruar mbi 30 milionë donacione dhe të cilat janë akorduar nga Banka Botërore, nga Bashkimi Evropian, që të forcojmë politikat e përgatitjes së mësimdhënësve.

Asnjë student që e ka kryer masterin në shkenca natyrore dhe në filologjik nuk do të dëmtohet sepse të diplomuarit e parë në master pedagogjik në edukim do t'i kemi në vitin 2017.

Prandaj, i nderuari profesor, ju lutem mos krijoni shqetësime tek mësimdhënësit. Asnjë mësimdhënës nuk do të largohet nga puna, por nga viti 2017 do të kemi mësimdhënës të specializuar, sepse kur dikush kryen biologjinë ai mund të punojë në laboratorë, mund të jetë hulumtues, por në qoftë se ai do të jetë mësimdhënës i mirë nuk i garanton dikujt që e ka kryer, dhe ai mund të jetë edhe doktor i biologjisë, por kurrë nuk mund të jetë mësues i mirë. Për të qenë mësues i mirë ai duhet të shkojë me një program edukativ i specializuar që ofron edukimi për mësues, sepse ai ato njohuri shkencore duhet t'i pajisë tani me njohuri pedagogjike.

Ne kemi me dhjetëra doktorë të shkencës, që nuk janë të aftë të jenë mësimdhënës. Po domi të krijojmë një sistem shtetëror të koordinuar që mësimdhënësit të krijohen me kritere dhe me standarde kombëtare.

Ky është një proces i pandalshëm dhe ju lutem bashkohuni në këtë proces sepse përfitues të këtij procesi do të jenë fëmijët tanë, që nesër do të marrin një edukim të mirë, një edukim cilësor që do t'i bëjë ata të aftë nesër që të kontribuojnë në jetë, kështu që ne kemi marrë disa shqetësime dhe unë e pashë letrën që e lexova, ajo letër ka ardhur nga një grup i studentëve dhe po më duket ju e keni marrë detyrë sot ta përfaqësoni atë komunitet. I kam takuar, i kam sqaruar dhe ata kanë mirëkuptuar. Nuk kemi të drejtë ne profesorët të krijojmë huti. Ne duhet t'u tregojmë se jemi të interesuar për të krijuar cilësi në arsim dhe duhet ta ndërpresim anarkinë në arsim.

Në qoftë se përditë jemi të pakënaqur, në qoftë se përditë diskutojmë në Parlament, dhe mua më vjen mirë që të diskutojmë, mua më vjen mirë që pyetjet më të shumta parlamentare po i bëhen ministrit të Arsimit. Ju kam thënë herën e kaluar, mos më bëni pyetje për shkollë e për çerdhe, por më bëni pyetje për cilësi. Ejani të debatojmë për cilësi, jo për çerdhe dhe për shkollë, dhe atëherë ju kisha lutur mos të krijojmë konfuzione, të punojmë bashkë, të krijojmë një sistem shtetëror të përgatitjes së mësimitdhënësve, sepse edhe një herë po e përsëris, këta 8 muaj një gjë e kam mësuar si ministër, nëse domi progres në arsim, nëse domi përparësi prej çerdheve e deri te Universiteti, çelësi i suksesit janë mësimitdhënësit e përgatitur. Ku kemi mësimitdhënëse të mirë, në cilëndo shkollë apo fakultet, aty kemi cilësi.

Po dua t'ju përkujtoj, në konkursin që posa e mbyllim, sot i kemi shpallur rezultatet dhe ka qenë sezoni më i mirë ndonjëherë i pranimi të studentëve dhe fakulteti më i kërkuar është Fakulteti i Edukimit.

I kemi 12 studentë për një vend. Pse, për shkak se ai fakultet po ofron standarde të mira për mësimitdhënëse, standarde të pranuar ndërkombëtarisht. Vetëm Qeveria e Kanadës i ka dhënë mbi 10 milionë në ndërtimin e këtij fakulteti, kështu që mos të shohim për interesa të vogla e të rrënojmë diçka që shteti i ka ndërtuar me vite të tëra.

KRYETARI: Faleminderit! Ka komente! Nait Hasani! Edhe ti je Shpejtim, por prit pak. Unë shkova edhe në bazë të partive, Naiti i PDK-së, Shpejtimi i LDK-së e më tej Xhevahirja. Urdhëro! Aha, po do i pari! Urdhëro, nëse të lejon Naiti! Po, atëherë urdhëro Shpejtim. S'prish punë! Desha të gjithëve t'ua jap fjalën!

SHPEJTIM BULLIQU: Faleminderit, zoti kryetar!

I respektuari ministër i Arsimit,

Këto të cilat ju i thoni, sigurisht se i di shumë mirë, sepse edhe unë jam në rrjedha dhe ndoshta në shumë aspekte më tepër se sa ju, në lidhje me Fakultetin e Edukimit.

Po ju bëj me dije, zoti ministër, Udhëzimi administrativ që është nxjerrë nga ana e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, numrin e të cilit nuk po mund ta mbaj përmendësh, nga zoti Buja, nga ministri Buja, decidivisht është thënë që dy vitet e studimeve master në Fakultetin e Edukimit do të jenë ekskluzivisht me lëndë pedagogjike.

Urdhëroni shkoni, zoti ministër dhe këqyrni çfarë lëndë janë në nivelin master në Fakultetin e Edukimit në programet lëndore, të cilat i nxjerrë Fakulteti i Shkencave.

Është shumë lehtë të flitet, por shkoni e këqyrni realitetin çfarë e ke. Unë vetëm po ju bëj me dije, zoti ministër, në qoftë se nuk e dini, drejtimi i gjeografisë në Fakultetin e Edukimit e ka një asistent gjeograf. Krejt Fakulteti i Edukimit e ka një asistent gjeograf. Ne nuk jemi kundër Fakultetit të Edukimit, mos të keqkuptohemi. Fakulteti i Edukimit duhet të nxjerrë profilet para fillore dhe profilet fillore për mësues. I tillë është i dedikuar.

Shikoni, i keni dhënë përparësi me Udhëzimin administrativ drejtimit matematikë – informatikë para drejtimit matematikë në nivelin e arsimit të mesëm të lartë. Mendoni që është në rregull kjo punë? Ata nuk mësojnë informatikë, por kanë për të mësuar matematikë në arsimin e mesëm të lartë.

Ju e dini shumë mirë korrikulat çfarë parashihen dhe kush mund ta mbajë mësimin në arsimin e mesëm të lartë.

Edhe një digresion po ju jap, zoti ministër, në qoftë se s'e keni parë. Shikoni pikën e arsimit të mesëm të lartë, shkalla e mesme e lartë 1.3 Fakulteti Filologjik, në fakt Filozofik, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe dhe Gjuhë e Letërsi Shqipe. I jepet, do të thotë, përparësi në arsimin e mesëm të lartë drejtimit gjuhë dhe letërsi shqipe në Fakultetin Filologjik.

E njëjta gjë nuk ndodhë për Fakultetin e Shkencave. Merreni këqyreni! Prapë, në Fakultet të Shkencave ju keni thënë përparësi, Fakultetit të Edukimit - matematikë informatikë që s'është në rregull, është gabim total i juaji ose i atyre që e kanë përgatitur këtë udhëzim. I keni dhënë përparësi Fakultetit të Edukimit- drejtimi gjeografi që nuk ka drejtim të tillë. Ende nuk është akredituar programi i gjeografisë, në qoftë se nuk e dini, në nivelin master nuk ka ende të akredituar në Fakultet të Edukimit.

I keni dhënë programit gjeografi, ose gjeografi edukatë qytetare, që prapë nuk ka program të akredituar të tillë në Fakultetin e Edukimit.

E njëjta gjë ka ndodhur me fizikën, e njëjta gjë ka ndodhur me biologjinë, me gjeografinë dhe lëndë tjera të Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

E njëjta gjë, që është digresion prapë, e ke gjuhën dhe letërsinë angleze. I keni dhënë përparësi në arsimin e mesëm të lartë Fakultetit Filologjik që pajtohem plotësisht dhe ashtu duhet të jetë.

Gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze u keni dhënë përparësi, ndërsa Fakultetit të Shkencave komplet lëndët ekzakte i keni tërhequr dhe i keni dhënë përparësi Fakultetit të Edukimit, të cilat drejtime ende nuk ekzistojnë në Fakultet të Edukimit, sepse nuk janë akredituar.

Prandaj është mirë që të shikohet ky udhëzim, sepse ne nuk kemi interes as nevojë të krijojmë panik, sepse shkresat që ju kanë ardhur ju kanë ardhur prej mësimdhënësve, jo prej meje dhe ky është paniku që e keni krijuar ju me këtë udhëzim administrativ, prandaj është mirë që të ulet edhe një herë, të rishikohet, të tërhiqet ky udhëzim administrativ, të analizohet më mirë gjendja faktike çfarë është në arsim, për arsye se ju e dini që ka jashtëzakonisht anomali të madhe në këtë udhëzim administrativ. Faleminderit!

KRYETARI: Nait, e keni fjalën! Ministër, në fund, nëse dëshironi, i përmbledhni pastaj komentet.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Edhe unë desha të lidhem me komentet e ministrit. Ne e kemi pritur ministrin në komision dhe ka deklaruar se do të jetë një nga ministrat që do të ngritë standardet e cilësisë, ndërsa me udhëzimin administrativ, për shkak të një ndërtese që e kemi të bukur të Fakultetit të Edukimit, nuk do të thotë se ajo duhet të jetë edhe strumbullar i të gjithë fakulteteve.

Kjo është një nga ato që duhet t'i kemi për një kuptim më të përafërt. Fakulteti i Edukimit, dhe studentët që kanë shkuar në Fakultet të Edukimit, 12:1 në raport me regjistrimit është çështja e punësimit, por është një çështje e fakultetit që ata e duan, për mungesë të punësimit në fusha të tjera dhe ata janë drejtuar drejt Fakultetit të Edukimit, sepse ka mundësi punësimi nëpër shkolla diku tjetër.

Çështja profesionale dhe fakultetet profesionale që janë, cila është arsyeja që ata me udhëzim administrativ që e ka nxjerrë Ramë Buja, ministër në vitin e kaluar, në gusht dhe ata të shkojnë ta bëjnë vazhdimin e studimeve në Fakultet të Edukimit. A e ka kryer gjuhën dhe letërsinë, a e ka kryer anglishten, a e ka kryer biologjinë, a e ka kryer, por nëse e ka kryer Fakultetin e Mjekësisë, ai tash duhet të shkojë të bëhet mësues, duhet ta kryejë edhe një kurs, një trajnim të Fakultetit të Edukimit për t'u bërë mësues i mirë i mjekësisë, shumë gjera janë absurde, të cilët janë me udhëzim administrativ. Prandaj, është kërkesë edhe e studentëve edhe atyre protestuesve. Ne kemi kërkuar që të mërkurën e ardhshme të vini në debat në komision, na sqaroni më tutje sepse nuk e kemi llogaritur që sot ta kemi një formë të tillë. Por megjithatë po kërkoj që udhëzimi administrativ që është nxjerr më 10 korrik ta shqyrtoni edhe një herë formën e tij sepse do të jetë një mundësi e mirë për mbrojtjen e cilësisë në arsim atë qysh e keni deklaruar.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! A është paraqitur dikush lidhur me këtë? Zoti Haxhiu, urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Po shfrytëzoj rastin që në këtë kohën e deklarimeve të tuaj në veçanti për cilësinë në arsim të ngre edhe një shqetësim të cilën e kam ngritur edhe para dy vitesh, kam përsëritur edhe disa herë. Jemi në fund të sesionit pranveror të kësaj legjislature dhe shoh një neglizhencë të Ministrisë së arsimit që përveç ajo që po shihet qartazi iniciativën tuaj për ngritjen e cilësisë në arsim, një problem është duke u neglizhuar është problemi i çantave të stërngarkuara shkollë, deformimeve të shtyllës kryesore të fëmijët.

Në bazë të hulumtimeve të bëra në shumë shkolla ka rezultuar që mbi 40% e fëmijëve vuajnë nga postura e shtyllës kurrizore dhe nga skolioza, kjo për shkak të stërngarkesës së çantave shkollë.

Para dy vjetësh në fund të sesionit kam ngrehur shqetësim me qëllim që Ministria e Arsimit të reflektoj dhe të merr hapat edhe në uljen e peshave të çantave shkollore qoftë në ndarjen e librave në dy forma ashtu siç e organizuar sistemi arsimor edhe periudhat shkollore nëse një libër e matematikës e mbanë fëmija në çantë prej fillimit të shkollimit deri në fund, atëherë nëse ndahet vetëm në 50% ajo mund të ndahet në dy pjesë, në pjesën e parë dhe të dytë, e kemi një zvogëlim të peshave të çantave dhe pastaj kujdesin më të madh në veçanti në përgatitjen e raftëve shkollore për libra në shkolla do të ndihmonte në zvogëlimin e peshave. Ne jemi që të kemi cilësinë në arsim dhe të kemi fëmijë të ngritura të edukuar, por gjithsesi duhet të kemi fëmijët e shëndetshëm dhe kjo është primare.

Mendoj që Ministria dhe kërkoj përgjegjësi që të merrni ndaj atyre të cilët me vite po e anashkalojnë këtë.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit pesha e çantave nuk guxon të kalojë 10% e peshës trupore të fëmijëve, ky i bie që një fëmijë 35-kilogramësh në shkollën fillore nuk mund ta ketë një çantë mbi 3,5 gjysmë, çanta e shkollave sot, të fëmijëve tanë është mbi 12 kilogram dhe kjo është e papranueshme.

Prandaj, kërkoj që përveç këtij problemi të cilin sot e ngritët të merreni seriozisht edhe me përgjegjësitë e arsimit të ulët të cilët e kanë përgatit kurrikulat për këtë nivel të arsimit e cila është në disproporcion me shëndetin e fëmijëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Për mundësinë që të reagoj ndaj akuzës së koleges sime Shqipe Pantina lidhur me procesin e votimit në komisin ad hoc për anëtarët e Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Shqipe Pantina është njëra...

KRYESUESI: Jo, jo, s'ke ti punë me diskutime tjera, veç në qoftë se e ke me ministrin e Arsimit, është kryer ajo.

Të kuptohemi, ne s'kemi të drejtë të replikojmë në pjesën e debatit. Kështu që nuk është mirë që të futemi në këtë mënyrë të debatimit, sepse pastaj duhet me ia dhënë të drejtën edhe asaj kundër replikë dhe s'e kryejmë deri nesër. Besoj që më kupton drejt. Faleminderit!

Zonja Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Me qenë se në kohën kur filloj procesi i reformimit në Fakultetin e Edukimit isha në Ministrinë e Arsimit, ndjej për obligim që të shpjegoj në pika të shkurtra kronologjinë.

Që nga vitit 2008, është menduar dhe është munduar Ministria e Arsimit që t'i fillojë reformat në Fakultetin e Edukimit me një kërkesë shumë rigoroze edhe nga Komisioni Evropian. Për faktin

se ishin dy institucione, dy fakultete që prodhonin kuadro për edukimin parauniversitar, apo për arsimin parauniversitar.

Dhe, në mandatin e kaluar, ministri Buja nxori vendimin për fillimin e reformave në Fakultetin e Edukimit dhe ekskluzivisht Fakultetin të Edukimit i mbeti që të përgatisë kuadro për edukimin para fillor dhe fillor. Më pastaj programet lëndore vijohen në fakultetet përkatëse dhe për të vazhduar me programe lëndore për të qenë mësues ose profesor të gjithë ata të interesuar duhet të vijojnë studimin në master plus një vit apo dy varësisht nga programi i cili do të akreditohet dhe të mund të përgatiten në rrafshin pedagogjik për mësimdhënie. Kurse për shkollat profesionale është çështje tjetër, ata nuk kanë nevojë që ta ndjekin masterin për njohuri pedagogjike të tjera.

Kështu që unë mendoj që kjo mund të korrigjohet, edhe udhëzimi, edhe të kërkohet nga Agjencia e Akreditimit që të përshpejton procedurat e akreditimit të programeve, të krijohen kuadro të profileve për mësimdhënie në fakultet të edukimit dhe kjo është ecuria që besoj ministri e shpjegoi shumë mirë që është duke u përgatitur dhe duke u punuar për ngritjen e cilësisë edhe në rrafshin e mësimdhënësve.

Mirëpo, si kronologji është për meritë dhe është për të lavdëruar puna që është bërë në marrjen e vendimit për fillimin e reformave në procesin e reformimit të përgatitjes së stafit të mësimdhënësve në shkollimin para universitar si fillor ashtu edhe para fillor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zori ministër, e keni fjalën në qoftë se dëshironi. Nuk ka pas fjalës së ministrit replika.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Në përgatitjen e këtij udhëzimi kanë marrë pjesë ekspertët më të mirë të Kosovës, duke përfshirë edhe profesorët e fakultetit të shkencave dhe profesorët e Fakultetit të Filologjisë.

Ata kanë qenë pjesë të grupit që e kanë përgatitur këtë normativ dhe i vetmi qëllim është për të ngritur standardet e mësimdhënies, cilësisë së mësimdhënies sepse ne të gjithë në Kuvend po pajtohemi që niveli i mësimdhënies është i dobët. Pse? Është i shkapërderdhur përgatitja e mësuesve është shkapërderdhur, shikoni edhe dikush e ka krye fakultetin Juridik, ai është jurist nëse mund të bëhet mësues, po ai nuk do të jetë mësues i mirë, ai mund ta njehë një lëndë por për me qenë mësues i mirë duhet të jesh pedagog i përgatit me shumë disiplinë.

Për këtë arsye reformimi i Fakultetit të Edukimit që është një projekt ndërkombëtar, kërkesë e Komisionit Evropian, e Bashkimit Evropian, kemi siguruar tash 11 milionë dollarë për t'i forcuar politikat e mësimdhënies nga shtatori do të marrim kredinë e bankës për t'i trajnuar krejt mësimdhënësit. Ka vetëm një qëllim, që të përgatit mësimdhënës lëndor të pajisur me njohuri pedagogjike.

Unë e di profesor Bulliqi që ju mund të nxjerri gjeograf apo biolog shumë të mirë, që mund të punojnë në laborator, mund të jenë doktorë të shkencës, mund të bëjnë edhe zbulime por duhet ta pranojmë se ata nuk mund të jenë mësues të mirë, pse. Për të qenë mësues i mirë ata duhet të kenë një prej lëndëve pedagogjike dhe ne kemi vlerësua se duhet ta krijojmë vetëm një institucion i cili i plotëson standardet kombëtare për mësimdhënës edhe kjo do të startojë në vitin

2017, asnjë mësimdhënës nuk do të mësoj tash i fakultetit të shkencave deri në 2017 kur del gjenerata e parë e masterit, sivjet janë akreditua 6 programe në master në Fakultetin e Edukimit dhe tek në 2017 ne do të kemi mësimdhënës plotësisht të përgatitur me standardet e Bashkimit Evropian për mësimdhënie.

Dëshiroj ta theksoj edhe një çështje. Siç e dini Ministria e Arsimit bënë licencimin e mësimdhënësve. Ne japim licencë dhe nga viti i ardhshëm me Ligjin për profesionet e rregullua secili mësimdhënës për me qenë mësimdhënës duhet ta japë edhe provimin shtetërorë të mësimdhënies. Të gjitha këto janë politika kombëtare që në shkollat tona duhet me përgatit arsimtar të mirë, dhe të gjithë jemi pajtuar që ne duhet të investojmë në ngritjen e cilësisë siç e thashë çelësi për suksesin është investimi te mësimdhënësit e përgatitur dhe t'i trajnuar nga kopshtet deri te universiteti.

KRYESUESI: Faleminderit! Si pikë e rendit të ditës është shteruar.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Rregullat i dini, pyetja e parë është për kryeministrin Isa Mustafa, nga deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Pyetja ka të bëjë me Kombinatin “Trepça” në veçanti me një keqmenaxhim në kombinatin tani kohëve të fundit.

Dhe në fillim të legjislaturës ne u përballëm me një falimentim juridik të “Trepçës” i cili tani po vazhdon me falimentim financiar dhe operacional. Derisa menaxhmenti i “Trepçës” në veri ka arritur të shes 24 milionë euro koncentratin për një viti, menaxhmentin në jug e ka futur “Trepçën” në borxhe dhe e ka vënë në kolaps financiar.

Prandaj, muajve të fundit është duke zhvatur edhe fondet e veçanta të AKP-së që kanë qenë të parapara për projekte zhvillimore të “Trepçës”. Mjetet financiare nga xhirollogaria e veçantë e AKP-së, pa vendim të bordit janë duke u shfrytëzuar për paga dhe mëditje dhe benifite të tjera të menaxhmentit të “Trepçës”, shkeljet ligjore të ligjeve të aplikueshme në Kosovë dhe ligjet e AKP-së.

Më 28 dhe 29 shkurt 2011, Bordi i AKP-së kishte vendosur të shesë disa nga mbeturinat industriale të Trepçës” dhe mjetet nga shitja e këtyre mbeturinave industriale të deponohen në një llogari të veçantë, ku saktësohet e shfrytëzimi i këtyre fondeve ekskluzivisht mund të përdoren vetëm me vendim të Bordit të AKP-së për projekte, për investime kapitale me qëllim të rritjes së vlerës së ndërmarrjeve sipas Ligjit të AKP-së.

Gjithashtu në mbledhjen e datës 29 mars 2012, Bordi i AKP-së merr vendim pika 7 e tij, paratë e fituara nga shitja e këtyre mbeturinave duhet të kalojë në një llogari të veçantë dhe çdo propozim për përdorim të mjeteve fillimisht duhet të aprovohet nga Bordi i AKP-së.

Me këto vendime kanë qenë të njoftuar edhe menaxhmenti i Trepçës dhe ai i AKP-së. prandaj, shfrytëzimi i këtyre mjeteve pa vendim të Bordit përbën shkelje ligjore.

Derisa ne kemi pritur që Qeveria bashkë me AKP-në dhe Trepçën të na sjellin për shqyrtim strategjinë dhe Ligjin për “Trepçën”, menaxhmenti i saj ka shfrytëzuar mungesën e bordit të AKP-së për të zhvatur fondet e parapara për projekte zhvillimore të “Trepçës”.

Andaj, kërkoj urgjentisht që të sjellin për miratim strategjinë dhe Ligjin për “Trepçës” dhe të hetohet shfrytëzimi i kundërligjshëm i mjeteve nga fondet e veçanta pa vendim të bordit.

Pyetja i nderuar kryeministër është. A e dini me cilin vendim u ridestinuan mjetet nga xhirollogaria e veçantë dhe sa para nga kjo xhirollogari...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, vazhdoja le ta përfundojë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar!

Me të cilin vendim u ridestinuan mjetet nga llogaria e veçantë, sa para nga kjo llogari janë shfrytëzuar dhe abuzuar kundërligjshëm nga menaxheri i “Trepçës” dhe ushtruesi i detyrës të zëvendësudrejtorit të AKP-së. Bordi i AK-së nuk është funksional nga data 1 shtator 2014, atëherë me vendim të kujt është duke u shfrytëzuar “Trepça”, këta tre muajt e fundit në fondet e AKP-së nga llogaria e veçantë. Bazuar në Ligjin e AKP-së vendimet e bordit të AKP-së janë në fuqi dhe ato mund të shfuqizohen vetëm nga organi që ka vendos për to. Prandaj, pyes a janë në fuqi vendimet e Bordit të AKP-së, nëse janë shfuqizuar këto vende, kush dhe kur i ka shfrytëzuar sepse bord të AKP-së nuk ka. Sa para janë marrë nga fondi i ngrirë, llogari e veçantë e AKP-së për paga dhe mëditje dhe benifite të menaxherit dhe menaxhmentit “Trepçës” në skuadrën e shpëtimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Unë e kam lexuar pyetjen që është shtruar, mund të them se me gjithë respektin për pyetjen dhe parashtruesin e pyetjes. Do të theksoj se Agjencia Kosovare e Privatizimit është agjenci e pavarur, e cila i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe si i tillë mendoj se ai dua të vijë dhe të raportojë në Kuvendin e republikës së Kosovës edhe për këto çështje edhe për çështjet e tjera. Jo që unë dëshiroj të devijoj nga vullneti im që të japë përgjigje por konsideroj se nuk mundem unë të prezantoj atë çfarë është bërë atje sepse është një agjenci e pavarur i cili përgjigjet Kuvendit dhe duhet të referoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket Qeverisë unë e pranoj se ne si Qeveri jemi vonuar me propozimin e Bordit të Agjencisë, do ta bëjmë shpejtë, do ta kompletojmë bordin e agjencisë, i cili do të votohet këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pastaj edhe ai bord edhe menaxhmenti ekzistues duhet t’i referojnë Kuvendit për të gjitha veprimet të cilat janë bërë, në qoftë se janë bërë veprime joligjore atëherë çdo njeri duhet t’i merr përgjegjësitë për këto veprime.

Mund të them po ashtu se ne nuk e kemi lënë anash as detyrimin tonë që e kemi marrë këtu lidhur me strategjinë e Trepçës dhe lidhur me Ligjin për “Trepçën”, po punohet edhe në njërin edhe të tjetrën. Ne jemi orientuar që konceptojmë fillimisht strategjitë për “Trepçën”, në mënyrë që pastaj Ligji për “Trepçën” të përshtatet me strategjinë për “Trepçën”.

Kemi zhvilluar konsultime të caktuara edhe me organizata ndërkombëtare në mënyrë që të kemi përvojat edhe të jashtme sa i përket strategjisë dhe do të mundohemi që ne t’i marrim përvojat më të mira në mënyrë që strategjia t’u përgjigjet nevojave tona konkrete, jo ta bëjmë strategjinë tonë mbi kopjimin e përvojave nga vendet e tjera sepse duhet të respektojmë përvojat tona dhe ambientin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu, pyetje shitesë për kryeministrin Mustafa.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryeministër!

Qëllimi i adresimit pyetjes në drejtimin e juaj ka qenë me ju bë dije një keqpërdorim i cili po ndodh dhe si kryeministër i vendit të jeni në dijeni për shpërdorimin e fondeve publike dhe kjo ka ngritë te unë edhe një dyshim tjetër që ushtruesi i detyrës zëvendësdrejtori të AKP-së ka pasur guximin të prek edhe fonde të tjera të AKP-së pasi këto fonde nga llogaria e veçantë veç ka pasur guximin t’i prek dhe ju të jeni në dijeni për këtë dhe gjithsesi insistimi edhe i im besoj që është edhe politike e juaja edhe e Qeverisë strategjisë dhe Ligji për Trepçën. Prandaj, kjo do ta ndihmonte edhe në zhvillimin e Trepçës, por do të ndalonte edhe keqpërdorimet e mundshme atje.

Keni pa këtë javë, ka pas dhe një protestë të minatorëve të cilët janë të pakënaqur me gjendjen në Trepçë edhe në veçanti me menaxhmentin e saj. Prandaj kam kërkuar që një insistim të juaj që vërtetë kjo çështje të vihet në binarë dhe të merr rrugën zhvillimore të Trepçës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ndonëse e kam përmendur shumë këtë çështje, megjithatë unë kam parashtruar pyetjen parlamentaren edhe për kryeministrin Mustafa, sepse nuk kam marrë përgjigje zyrtare të paktën nga Zyra e Kryeministrit.

Më 14 prill 2015, me anë të një shkresë kam kërkuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit që të filloj hetime për parandalimin e konfliktit të interesit në rastin e zotit Besnik Berisha, këshilltarit të kryeministrit Mustafa për çështje të drejtësisë.

Një muaj pas saktësisht më 18 maj, Agjencia Kundër Korrupsionit me anë të një vendimi pati mbyllur rastin për parandalimin e konfliktit të interesit ndaj zotit Berisha, për faktin se siç thuhet në vendimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, po citoj: “I njëjti ka dhënë dorëheqje nga këshilltari për çështje të drejtësisë”. Edhe përkundër këtij vendimi zoti Berisha prononcohet publikisht si këshilltar i kryeministrit Mustafa.

Pyetja parlamentare për zoti Mustafa është se cili është roli juaj, zoti kryeministër, në mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 99, paragrafi 1 të pikës 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur

me përgjegjësitë për zbatimin e ligjeve për rastin konkret. A nuk e konsideroni që konflikti i interesit është rrethanë faktike dhe jo e supozuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, deputete Haxhiu!

Është e vërtetë se kam marrë kërkesën e këshilltarit tim Besnik Berisha, që ai të tërhiqet nga pozita e këshilltarit politikë, për arsye se ka qenë vërejtja e agjencisë se ajo paraqet një konflikt interesi si i tillë, ai është tërheqë e kam shkrua vendimin për shkarkimin e tij nga këshilltari politikë dhe ai pastaj është angazhuar në cilësinë e ekspertit këshilltarë për zhvillimin e kapaciteteve në institucionet e Republikës së Kosovës në bazë të mbështetjes nga organizatat e jashtme jo INDP-së dhe KFOS-it, do të thotë nuk është në cilësinë e këshilltarit i cili me ligj trajtohet si konflikti interesi por është ekspert i angazhuar. Dhe unë mund të ju them jo vetëm atë por do të angazhoj edhe ekspertë të tjerë sepse unë s'mund të kem njerëz që më këshillojnë ose më japin sugjerime edhe të cilët profesionalisht janë të pangritur dhe që nuk i plotësojnë këto kushte.

Ne e kemi njoftuar agjencinë lidhur me këtë dhe ne nuk kemi pasur asnjë vërejtje të mëtutjeshme të agjencisë lidhur me angazhimin e jashtëm të tij si ekspertë këshilltarë dhe ai vazhdon ta kryej këtë punë. Por, ajo çfarë mund të konsideroni ju si konflikt interesi është çështje e vlerësimeve individuale. Ne duhet të konsultohemi me ekspertë, ne duhet vetë t'i marrim vendimet dhe ne vetë e mbartim përgjegjësinë për marrjen e vendimeve. Prandaj, qoftë si këshilltar, qoftë si ekspertë ne duhet gjithsesi të bashkëpunojmë me njerëz, mirëpo ne jemi ata të cilët e marrim përgjegjësinë vetë lidhur me vendimet të cilat ne i marrim. Ai mund të mos jetë as këshilltar as ekspertë por edhe privatisht unë mund të ulem edhe ta këshilloj. Atëherë dikush do të thoshte po ushtron ndikim, ne s'kemi qare pa i konsultuar ekspertët, por jemi në atë situatë që ne do të marrim vendime vetë.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Haxhiu?

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë, natyrisht që ju duhet të keni këshilltar askush nuk po e konteston këtë. Ndonëse po ju këshillojnë keq sepse ne e njohim zotin Berisha se cili ka qenë pretendimi i tij në vazhdimësi për riprocedimin e amendamentit për Gjykatën Speciale.

Së pari, sipas Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, zyrtari i lartë publik pra kur hyjnë edhe këshilltarët nuk mund të jenë avokat, ndonëse ju po thoni që tash quhet ekspertë, këshilltarë kjo është sikur fiskullturë që tha Ismajl Kurteshi dhe nuk keni bërë asgjë në fakt.

Së dyti, sipas Ligjit për avokatin neni 39, në momentin kur një avokat krijon marrëdhënie punës dhe tani paguhet NDP dhe do të thoja pra është, ka krijuar marrëdhënie të punës e humb të drejtën ose licencën e të qenit avokat.

Së treti, sipas po këtij ligji, avokati është profesion i pavarur dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Po, po, përfundoje pyetjen!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Dhe të qenit këshilltar politik nënkupton që ata janë të obliguar të demonstrojnë lojalitet personal dhe përkushtim politik për eprorin e tyre, në këtë rast për juve.

Dhe, gjithashtu zoti Berisha është anëtar edhe i Këshillit Drejtues të LDK-së, çfarë organi është Këshilli Drejtues zoti Mustafa, sepse ai po thotë jam në cilësinë e ekspertit, a është Këshilli Drejtues i LDK-së organ ekspertësh apo është organ politik, sepse unë e di që Këshilli juaj Drejtues është organ ekzekutiv dhe vendimmarrës. Pra, nëse keni mundësi të më përgjigjeni edhe për këtë çështje. Natyrisht që problemi kryesor nuk është zoti Berisha, problemi kryesor këtu jeni ju vetë pra koalicion PDK-LDK dhe Lista Serbe të cilët po ofroni politika të mbrapshta dhe thellim të degradimit të vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Ajo që është për juve është problem për mua nuk është problem, për mua është kënaqësi që qeverisim vendin, për ju është problem. Mirëpo të kthehemi tek tema.

Ai nuk është këshilltar politik, ne i kemi 99 anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së, dhe të 99-it nuk janë këshilltar të mi, por të 99-it i këshilloj në pikëpamje të politikave të cilat ne i ndërtojmë po jo në cilësinë e këshilltarëve politikë që vijnë në kundërshtim me ligjin ose në kundërshtim me dispozitat ligjore. Çështje tjera që kanë të bëjnë me ligjet, rregulloret të cilat rregullojnë pozitën, fushëveprimin, përgjegjësi të avokatëve janë çështje të avokatëve nuk janë çështje të mi. Çështjet a ju pëlqen apo s'ju pëlqen juve qëndrimi i zotit Berisha lidhur me Gjykatën Speciale, prapë janë tjera çështje politike për të cilat ju pastaj s'mundeni me e vu këtë në kontestin e konfliktit të interesit. Prandaj, ajo që për mua është me rëndësi është se ai nuk paguhet me para publike në Qeveri dhe se ai nuk e ka cilësinë e këshilltarit politikë por e ka cilësinë e ekspertit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi, ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen. Jo! në rregull!

Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

REXHEP SELIMI: Më në fund, është hera e gjashtë që bëj pyetje për kryeministrin, është hera e parë që kryeministri është i pranishëm për pyetjen.

Por, si do qoftë nuk do të ndalem vetëm te pyetjet e mia drejtuar kryeministrit por do t'i ndaj me ju disa statistika që kanë të bëjnë po ashtu me pyetje që do t'ia adresoj kryeministrit.

Deputetët e Parlamentit të Kosovës që nga janari i këtij viti deri më tani kanë parashtruar gjithsejtë ose përafërsisht 180 pyetje parlamentare.

Zoti kryeministër, Kabineti juaj u është përgjigjur vetëm 78 pyetjeve parlamentare duke mos përfshirë përgjigjet e sotme eventuale që i bie që më shumë se 100 pyetje kanë mbetur pa përgjigje parlamentare.

Prej 178 pyetjeve ose 180 pyetjeve, 29 pyetje duke mos përfshirë seancën e sotme dhe të kaluarës për shkak se kjo pyetje është bërë për seancën e kaluar. Ju zoti kryeministër jeni përgjigjur vetëm në 12, duke mos përfshirë përgjigjet e sotme.

Me Rregulloren e Kuvendit që është akti me të cilin Kuvendi organizohet dhe funksionon është rregulluar edhe çështje e pyetjeve parlamentare dhe pyetja ime parlamentare është: Zoti kryeministër pse në përgjithësi nuk po i përgjigjeni pyetjeve parlamentare. Prapë e theksoj duke e përjashtuar ditën e sotme duke marrë prezencën tuaj si një përjashtim i gjithë kësaj. Pra, pyetja ime është, pse në përgjithësi në vazhdimësi nuk po u përgjigjeni pyetjeve parlamentare.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Tash se di sa mund të konsideroj këtë pyetje por për shkak të respektit ndaj deputeti dhe deputetëve. Ne do të bëjmë përpjekje maksimale që t'u përgjigjemi pyetjeve me Rregulloren është përcaktuar se cila është forma e përgjigjes së pyetjeve dhe cila është forma pastaj në qoftë se nuk i përgjigjet pyetjeve që të prezantohet publikisht edhe mos përgjigja e pyetjeve. Unë nuk do të kisha dëshirë që të vonohem në përgjigjen e pyetjeve, pastaj pas dy seancave ajo të shpallet se nuk është përgjigj. Do të bëjmë përpjekje që t'u përgjigjem, nuk e kam ndonjë arsye të veçantë që të them të evitoj përgjigjen e pyetjeve sepse asnjë pyetje deri më tani shtruar nga deputetët qoftë të opozitës që janë më shumë pyetje, qoftë të pozitës nuk kanë qenë pyetje në të cilat nuk kemi mund me dhënë përgjigje, na pëlqejnë përgjigjet apo janë çështje tjera. Por unë do të bëjë përpjekje maksimale që për sa kam kohë dhe mundësit të japë përgjigje. Një gjë që do të dëshiroja është që pyetjen na arrin pak më herët sepse unë pyetjet për sot i kam marrë dhe në mëngjes përpos këto që datojnë prej një javë më parë ose ka edhe pyetje tjera që cilave nuk ju kam përgjigj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi, pyetje shtesë?

REXHEP SELIMI: Faleminderit zoti kryesues!

Normalisht që kur e bëra pyetjen mendoj që është pyetje me vend, pyetja pse nuk i përgjigjesh pyetjes. Po mendoj që e ka esencën e vetë brenda kësaj pyetjes, nuk është pyetje pa vend.

Duke e ditur që ju radhë herë keni munguar por shpeshherë keni qenë këtu dhe nuk keni qenë brenda sallës për t'iu përgjigjur pyetjeve, po mendoj që keni mund të gjeni kohë më shumë për të përgjigjur pyetjeve, por si do qoftë prapë se prapë në bazë të Rregullores e cila ju obligon edhe ju të ju përgjigjeni pyetjeve parlamentare në kohën kur nuk keni kohë ta them prej agentes tuaj të ngjeshur të ju përgjigjeni pyetjes parlamentare atëherë pse nuk na u keni përgjigjur me shkrim për shkak se Rregullorja parasheh së paku kur në mungesën tuaj fizikisht të na përgjigjeni me shkrim.

Në fund dua të ju drejtohem kryeministër, që përgjigja në pyetjet parlamentare është një obligim qeveritar ndaj parlamentit për shkak se Qeveria do të duhej t'i përgjigjet Parlamentit edhe në këtu nuk kemi thjesht pyetje personale, ne pyetjet tona i parashtrijmë në interes të qytetarëve,...

(Ndërprerje nga regjia)

KRESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj, pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Zoti ministër,

Shkolla fillore dhe e mesme “Edmond Hoxha” në Junik numëron rreth 850 nxënës dhe rreth 40 mësime të cilët vijojnë mësimin në një objekt të vjetër të dëmtuar dhe përkundër ndërhyrjeve të kohëpaskohshme me riparimet e vetës komunës ky objekt është mjaft i amortizuar.

Objekti i Shkollës “Edmond Haxha” është ndërtuar në vitin 1946 dhe nuk i plotëson kushtet që edhe më tej t'i zhvillohet proces normal edukativo arsimor.

Duke qenë se komuna me një buxhet aq të vogël nuk ka mundësi të ndërtojë një objekt të ri, ata kanë bërë kërkesë tri vite radhazi që të finalizohet ndërtimi i një objekti të ri nga Ministria e Arsimit, por kjo edhe sot e kësaj dite nuk po ndodhë.

Qytetarët e komunës së Junikut, prindërit e nxënësve nuk po donë që edhe më tutje të jenë të rrezikuar jetët e fëmijëve të tyre duke qëndruar nën kulmin e asaj shkolle.

Prandaj, me të drejtë presin që Qeveria qendrore buxhetin e së cilës e mbushin edhe tatimet e tyre të filloj sa më parë ndërtimin e asaj shkolle.

Ministër, kur do të filloni dhe a do ta përkrahni një projekt të tillë të komunës së Junikut.

KRYESUESI: Zoti ministër Bajrami, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, e nderura deputete Kadrijaj!

Para se të japë një përgjigje decidojmë më lejoni të ju njoftoj se ndoshta edhe e dini nga ky vit Ministria e Arsimit nuk merret më me ndërtimin e shkollave, kjo kompetencë me vendimin tim është bartë tani te komunat.

Sa i përket shkollës konkrete, më lejoni të ju informoj që një nga vizitat e para që kam bërë në shkollat e Republikës së Kosovës ka qenë shkolla “Edmond Hoxha” dhe bashkë me kryetarin e komunës ne jemi pritur nga stafi mësime të cilët dhe nga nxënësit e kësaj shkolle. Kemi vizituar dhe kemi vlerësuar që është një shkollë mjaft cilësore, një shkollë që ka një traditë po një shkollë që donë kujdes më të madh të komunës për të bërë një renovim.

Të ju njoftoj se në vitin 2014, Qeveria e Kosovës ka ndarë 120 mijë euro me të cilën është rinovuar kjo shkollë dhe kemi një investim bukur të madh të Qeverisë që janë rregulluar

ambientet dhe Qeveria po ashtu në vitin 2008 ka ndarë 600 mijë euro me të cilën është ndërtuar shkolla e mesme në Junik.

Ne do të punojmë bashkë me komunën, me kryetarin e komunës, me drejtorin komunal të arsimit të komunës së Junikut që brenda grandit specifik i cili ndahet komunave për nevojat e financimit të shqyrtojmë, të gjejmë mjete shtesë për renovimin e kësaj shkolle apo ndërtimin e një shkolle të re. Të keni parasysh se në Republikën e Kosovës kemi qindra shkolla në gjendje shumë më të keqe se shkolla e Junikut. Por ne do të punojmë që të gjejmë mjete që edhe kjo shkollë edhe për shkak se e mbanë emrin e heroit kombëtarë edhe për shkak të komunitetit edhe për faktin që është komunë e re të jetë një prioritet dhe bashkë me komunën do të koordinohemi në gjetjen e fondeve për ndërtimin dhe renovimin e kësaj shkolle.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj, pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Ministër, bashkë për atë se Juniku është një komunë e re, është dashur me pas një përkrahje më të madhe institucionale prej Qeverisë së Kosovës, dhe nëse ka me mijëra shkolla është dashtë me ju dhënë prioritet se siç e thash edhe më parë kjo shkollë është ndërtuar në vitin 1946 që po dihet sa është e vjetër kjo shkollë.

Dhe është edhe një arsye shtesë qysh e cekët, sepse kjo shkollë mban emrin e dëshmorit të kombit “Edmond Hoxha” që është edhe një arsye shtesë që Qeveria ish dashtë mu mobilizua që me e ndihmua komunën. Komuna me mjete buxhetore që i ndahet komunës së Junikut nuk ka mundësi me e ndërtua një shkollë.

Prandaj, me të drejtë qytetarët e Junikut presin përkrahjen e institucioneve qendrore për ndërtimin e një shkolle. Këtu është edhe kryeministri edhe është dashtë për herë të qytetarëve të Junikut të marrim një zotim se ndoshta shpejtë edhe junikasit do ta kenë një shkollë të re sepse e meritojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Deputete Kadrijaj,

Unë e thashë se ndër shkollat e para që kam vizituar, edhe për shkak të emrit, edhe për shkak të faktin që e mbanë emrin e studentit tim të shkëlqyeshëm ka qenë kjo shkollë dhe nuk është e vërtetë se Qeveria e Kosovës nuk ka investua, unë e përmenda shifra konkrete afro 720 mijë euro janë investuar nga Qeveria e kaluar, është ndërtuar shkolla e mesme komplet dhe janë ndarë 120 mijë euro është rinovuar kjo shkollë. Por unë nuk do të pushoj së angazhuari që bashkë me komunën e Junikut që bashkë të llobojmë që të risim grandin specifik dhe të ndërtojmë një shkollë të re krejtësisht sepse kemi edhe 73 shkolla të tilla në Kosovë të vitit 1946, kemi edhe shkolla që pritet edhe të rrënohen, por nuk ka shteti mjete për t’i ndërtuar të gjitha, por do të jetë një prioritet i veçantë komuna e Junikut.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Kadrijaj, prapë pyetje për ministrin Lutfi Zharku.

TIME KADRIJAJ: Ministër, rruga Junik-Gjeravicë është një çështje jetike për zhvillimin e turizmit në këtë trevë edhe të ekonomisë në komunën e Junikut. Prandaj, nuk ishte dashur që ky projekt kaq i gjatë dhe të mos përfundojmë punimet. Qeveria të merr seriozisht dhe të përfundojë edhe 7 km që kanë mbet pa u përfshirë në projekt. Kur do të vazhdohet me projektin, sepse sipas një projekti që është ndërtuar nga Ministria e Infrastrukturës është përkrahur ky projekt, domethënë rruga Junik-Gjeravicë kanë përfunduar gjithsej 14 km të asfaltimit të asaj rruge, ndërsa në projekt kanë mbet edhe 8 km.

Ministër, kur do të vazhdohet me realizimin e këtij projekti?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën?

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zoti nënkryetar, kryeministër,
Zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,
E nderuar deputete Kadriaj,

Ministria e Infrastrukturës në nëntor të vitit 2013 e ka nënshkruar kontratën për projektin e ndërtimit të rrugës Junik-Gjeravicë në gjatësi prej 9,5 km në vlerë prej 477 519 euro, kurse punimet janë zhvilluar siç e dini në vitin 2014. Prapë, në tetor të vitit 2014 kanë nënshkruar kontratën për vazhdimin e projektit të njëjtë në gjatësi prej 3,82 km vlera e kontratës ka qenë 185 mijë e 641 euro. Kurse, punimet natyrisht po zhvillohen gjatë këtij viti.

Mosrealizimin me kohë kanë ndikuar disa faktorë duke filluar nga pozita e terrenit i cili është malor ku reshjet e shiut kanë qenë më të shpeshta dhe në sasi më të mëdha. Po ashtu, meqenëse kjo zonë është pak nacional për hapjen e trasesë, gjegjësisht për prerjen e drunjve është dashur të sigurohet edhe pëlqimi nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Në anën tjetër me rastin e përpilimit të këtij projekti nga ana e projektuesit nuk është paraparë kategoria e terrenit 5 dhe 6 që ka pasur për pasojë kontraktimin e punëve shtesë.

Siç e ceka më lartë realizimi i këtij projekti është në vazhdim e sipër dhe presim të përfundojë brenda një muaji për shkak të punëve shtesë. Për shkak të buxhetit të limituar që ka Ministria e Infrastrukturës për këtë vit nuk ka qenë e mundur të vazhdohet në fazën e tretë këtij projekti gjatë këtij viti. Megjithatë, Ministria e Infrastrukturës ashtu siç e kam njoftuar edhe kryetarin Kuçi do të shikojmë mundësinë që pjesën e mbetur të kësaj rruge ta përfshijë në buxhetin e vitit të ardhshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadriaj, dëshironi pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Po, e keqja e kësaj Qeverie, e cila është trashëgimi, dhe asaj të kaluar, është se thuajse asnjë projekt në zonën e Dukagjinit nuk e ka dërguar deri në fund.

Në çdo sektor janë lënë projekte të përgjysmuara dhe kjo nuk është e drejtë, sepse edhe ajo është pjesë që participon në buxhetin e përgjithshëm të Kosovës. Andaj, ministër ne po bazohemi në zotimin tuaj që ajo rrugë siç e thash është një rrugë jetike, është një rrugë që e mundëson zhvillimin ekonomik të një komune të re, e cila kërkon përkrahje dhe po bazohemi në premtimin

e juaj që ju me gjithë ato pengesa që paskeni do e realizoni këtë projekt, i cili është nënshkruar në ministrinë e juaj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën për t'u përgjigjur.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Zonja deputete, veç mos me marrë si premtim kam për t'u munduar, por jo premtim.

KRYESUESI: Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Valon Murati.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I nderuari ministër,

Procesi i regjistrimit të diasporës ka filluar në fund të vitit 2013 dhe akoma po vazhdon. Tashmë dihet që prej fillimit të këtij viti është shtuar intensiteti i punës nga ana e ministrisë suaj për këtë proces.

Atë që unë dua ta di është si po e presin bashkatdhetarët procesin e regjistrimit të diasporës dhe a po zhvillohet sipas planifikimit ky proces?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI VALON MURATI: I nderuar kryesues!

Deputetë,

Kabinet qeveritar,

E nderuara deputete Mustafa,

Procesi i regjistrimit të diasporës i paraparë edhe me strategjinë për diasporën dhe mërgatën 2013-2017 është një proces i rëndësishëm për vendin, sepse duke pasur një bazë të konsoliduar të të dhënave mbi numrin, shtrirjen, profesionin, shoqatat, bizneset e tjera të bashkatdhetarëve tanë ne si shtet do të mund të ndërtojmë politika më të mira dhe më efikase në raport me Diasporën tonë.

Duke qenë të vetëdijshëm se ky është një proces kompleks i cili do të kishte qenë më mirë të realizohej së bashku me regjistrimin e popullsisë, por që për shkak të kriterëve të caktuara nga Eurostat nuk janë arritur rezultate të kënaqshme, atëherë realizimin e këtij procesi e ka filluar Ministria e Diasporës. Duke qenë se ky proces në të kaluarën ka çaluar ne kemi vendos që kjo verë të jetë një verë e mobilizimit tonë maksimal, siç e dini me ndihmën e partnerëve tanë UNDP-së dhe IOM-it kemi filluar fushatën e regjistrimit të diasporës me moton "ti je pjesë e atdheut". Përderisa, përqendrimi i aktiviteteve të fushatës së regjistrimit do të jetë në muajt e verës dhe të dimrit, atëherë kur bashkatdhetarët vijnë në Kosovë ne me procesin e regjistrimit do të vazhdojmë edhe në pjesën tjetër të vitit duke shfrytëzuar platformën online, por edhe ambasadat, konsullatat, si dhe aktivitetet e ndryshme që zhvillohen në Diasporë.

Ne kemi vendosur diku 100 regjistruar në gjithë Kosovën, nëpër komuna, qendra të regjistrimit civil, si dhe në pikat kufitare të cilat i presin bashkatdhetarët dhe bëjnë regjistrimin e tyre. Në bashkëpunim me Postën dhe Telekomin e Kosovës regjistrimi po realizohet edhe në mbi 100 pikat të Postës së Kosovës me që rast bashkatdhetarët tanë marrin një numër të Valës me një sasi

të caktuar të minutave, megabajtëve, e mesazheve falas, si dhe afat skadimi një vjeçar. Më duhet të theksoj se me vendim të Qeverisë procesi aktiv i regjistrimit do të zgjas deri në fund të vitit të ardhshëm dhe rezultatet e para preliminare priten të dalin në fillim të vitit 2017.

Regjistrimi pasiv, ai online do të zgjasë edhe për 5 vjetët e ardhshme. Informatat fillestare mbi fushatën “ti je pjesë e atdheut” janë se kemi një përgjigje pozitive të bashkatdhetarëve në këtë proces të regjistrimit, sidoqoftë unë shfrytëzoj rastin që të kërkoj përkrahjen e të gjithë juve deputetëve të Kosovës, të Kuvendit të Kosovës që kudo që jeni këto ditë në aktivitete me bashkatdhetarë të shfrytëzoni rastin dhe t’i ftoni ata që të regjistrohen duke ua larguar çfarëdo dyshimi dhe hezitimi mbi arsyeshmërinë dhe besueshmërinë e regjistrimit të diasporës.

Gjithashtu, dua të falënderoj të gjithë bashkatdhetarët që iu kanë përgjigjur deri tash këtij procesi dhe u bëj thirrje të gjithë të tjerëve që nuk e kanë bërë deri më sot ta bëjnë në ditët në vijim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

TIME KADRIJAJ: Ministër, faleminderit për përgjigjen dhe për aktivitetet dhe punën që po bëni për regjistrimin e diasporës, a mendoni se duhet ndonjë aktivitet shtesë për sensibilizim të regjistrimit të diasporës përveç këtyre punëve që po i bëni, sepse unë këto ditë kam has në bashkatdhetarë që pyesin dhe nuk kanë mjaftë qartësi për regjistrimin e tyre.

Mendoj, a keni në plan ndonjë aktivitet shtesë?

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI VALON MURATI: Realisht ne i kemi të përqendruar ju thash nga një fushatë e cila është edhe nëpër media, është edhe nëpër e kemi shtri nëpër të gjitha komunat e Kosovës dhe në qendrat e regjistrimit civil. Duke qenë se ne kemi shumë bashkatdhetarë po mendoj që ne me kapacitetet tona si ministri jemi duke e bërë atë që është optimale, por sigurisht që çdoherë mundet më shumë, por jemi duke e bërë optimalen që t’i njoftojmë me këtë proces.

E shfrytëzoja rastin kur e bëtë këtë pyetje që të kërkoj edhe ndihmën e juaj edhe ndihma juaj po mendoj që është goxha e rëndësishme në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Skënder Hyseni. Nuk është as Dauti as ministri. Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zoti Kurteshi e keni fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Desha t’i them Rexhep Selimit se ka edhe më keq, e kjo është hera e shtatë që po i drejtohem kryeministrit dhe më në fund ia arritëm që të jetë këtu një herë.

Zoti kryeministër, nënkryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut, Goran Rakiq para disa dite ka deklaruar se ka qenë pjesë e delegacionit të Serbisë në bisedimet Kosovë-Serbi në Bruksel. Kur nënkryetarin Rakiq e kanë pyetur si është e mundur një zyrtarë i Kosovës të jetë pjesë e

delegacionit të një shteti të huaj në bisedime me shtetin e tij, ai është përgjigjur: nëse ata, pra fjalën e ka pasur për institucionet e Kosovës dhe ju konkretisht zoti kryeministër, konsiderojnë se komunat e veriut janë pjesë e Kosovës atëherë pse ata duhet të bisedojnë me Beogradin, pse nuk thonë kjo është jona dhe nuk kemi çfarë të bisedojmë. Pra, ju pse s'i thoni kështu Beogradit.

Zoti kryeministër, si e komentoni faktin që një zyrtarë i Kosovës bëhet pjesë e delegacionit të Serbisë në Bruksel dhe si e komentoni deklaratën e tij në lidhje me komunat e veriut?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Tani unë e kam këtu zoti deputet evidencën e pjesëmarrjes në takimin e Brukselit, më datën 17 qershor këtu thuhet lidhur me barrikadat dhe në delegacion kanë qenë Edita Tahiri, Dren Zeka, Elona Cecelia, Besnik Osmani, Arben Çitaku, Shqipe Mjekiçi, Agim Bahtiri, Goran Rakiçi, Rashit Çelaj, Rron Çupeva,...

Goran Rakiçi ka qenë pjesë e jonë, ka qenë pjesë e ekipit të Kosovës, nuk ka qenë pjesë e ekipit të Serbisë edhe ai nuk është nënkryetar, por është kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore çka thotë ai pasi del prej aty është pastaj çështje e tij, mirëpo do të thotë ai ka qenë pjesë e jona, ka marrë pjesë së bashku me kryetarin e Mitrovicës së Jugut me zotin Agim Bahtiri në trajtimin e çështjes së lirimit të urës së mbi Ibër e cila nënkupton pastaj kalimin e këmbësorëve, kalimin e automjeteve, dhe qarkullimin e lirë mbi urë.

Objektivë themelore është që të integrojmë serbët e komunave të veriut në gjithë sistemin tonë kushtetues dhe sistemin ligjor, ajo është përpjekja e cila po bëhet, po bëhet në bazë të marrëveshjes së parë e cila është arritur në vitin 2013 dhe e cila është ratifikuar këtu në Kuvend, prandaj unë nuk mund të komentoj deklaratat e tij por mund të them që ai ka qenë pjesë e delegacionit tonë, nuk mund të them se nuk ka pas tentime prej njerëzve që kanë shkuar nga Kosova që të bashkëngjiten delegacionit të Serbisë, por ka qenë një kundërshtim i bashkëpunëtorëve të Mogerinit që ajo të lejohet dhe nuk është lejuar në asnjë rast që njerëzit nga Kosova të jenë pjesë e delegacioneve të tilla.

KRYESUESI: Pyetje shtesë?

ISMAJL KURTESHI: A i bie kjo që po mos kishte kundërshtuar Mogerini, sa për delegacionin e Kosovës ata lirshëm ishin bërë pjesë e delegacionit të Serbisë, dhe kështu kryeministër?

Përveç këtij, zotëriut që paska qenë sipas jush në delegacionin e Kosovës edhe zëvendëskryeministri serb, edhe ministrat serb nga Lista serbe jo një herë, por shumë herë kanë deklaruar se ata mbrojnë interesat e Beogradit edhe përherë kur i keni ftuar ju dhe kur i ka ftuar Vuçiçi ata i janë përgjigjur ftesës së Vuçiçit.

Çka e keni ndërmend ju të ndërmerrni kundër gjithë këtyre që paguhen në Kosovë e punojnë për Beogradin, nëse ndonjëherë i pengon Mogerini, atëherë është meritë e saj dhe çka do të bëni ju që të mos e lejoni jo vetëm të jenë pjesë e atyre delegacioneve, por që edhe të mos punojnë për Beogradin por të punojnë për interesa të këtij vendi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Tash rregullat e Brukselit nuk i përcaktojmë ne. Rregullat e Brukselit i përcakton Brukseli unë fola për ato rregulla, të cilat vlejné atje, sepse delegacionet janë të ndara prandaj, njerëzit nga Kosova mund të jenë vetëm pjesë e delegacionit të Kosovës dhe jo delegacionit të Beogradit.

Nuk është puna a mundemi apo s'mundemi, sepse ne si Kosovë ne në Bruksel nuk mund të përcaktojmë rregulla, ne themi që nuk ulemi të bisedojmë me ta në qoftë se delegacionet janë të përziera dhe nuk ka ndodhur në asnjë rast prej që kemi pasur dialog atje që të kemi njerëzit nga Kosova qoftë serb apo të tjerë si pjesë të delegacionit të Serbisë në të cilat kemi biseduar si dy delegacione.

Çështja tjetër është se ne po bëjmë përpjekje, prandaj nuk mund t'i mbyllim sytë para faktit që t'i integrojmë serbët në organet e institucionet e Republikës së Kosovës. Përpara s'e kemi pasur asnjë serb nga veriu, tani i kemi pjesë të Kuvendit të Republikës së Kosovës edhe shumë mirë janë këtu, sepse po bëjnë po marrin pjesë me neve në vendimmarrje.

Nuk është lehtë, kemi probleme të cilat themi ne nuk mund t'i fshehim, por po bëjmë përpjekje që ne t'i kapërcejmë këto probleme. Deputetët këtu e kanë dhënë betimin e tyre në bazë të ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ministrat këtu do të thotë janë zotuar mbi bazën e ligjeve dhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ne po bëjmë përpjekje që ato t'i realizojmë në jetë edhe unë mendoj që ne të gjithë bashkarish duhet të punojmë në këtë më mirë është që ne të bashkëpunojmë se sa që ne të krijojmë kundërshtarë, sepse kundërshtarët këtu nuk na nevojiten për arsye se duhet të marrim vendime shumë të rëndësishme që nënkupton se nganjëherë ato vendime nuk janë të lehta për arsye se duan 2/3 e gjithë deputetëve e 2/3 e popullatës pakicë që nuk e kemi përcaktuar ne si të themi koalicion por është përcaktuar në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të pakos së Ahtisarit, prandaj ne atë që po bëjmë, po e bëjmë përpjekje që ne t'i integrojmë të gjithë qytetarët tanë, jo që t'i dezintegrojmë.

Dhe, për këtë duhet të punojmë bashkërisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Kurteshi, prapë pyetje për ministrin Arsim Bajrami.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit! Zoti ministër, bazuar në listën e çerdheve për fëmijë, del se në Kosovë ka më shumë çerdhe private se publike.

Por, çerdheve të licencuara private ia shtojmë edhe çerdhet ilegale numri i të cilave nuk dihet atëherë disproporcioni në favor të çerdheve private rritet. Duke pasur parasysh se arsimit parauniversitar është në kompetencat e komunave por pasi që MASHT-i i licencon çerdhet private drejtoritë komunale të arsimit nuk i mbikëqyrin këto çerdhe, pra çerdhet private kështu del se çerdhet private nuk kontrollohen nga askush.

Edhe diçka kam shtuar këtu vetë, pra çerdhet private nuk iu kontrollohet as programi, as ushqimi, as kushtet e punës, të qëndrimit, as kualifikimi i edukatoreve, janë jashtë kontrollit edhe pse dihet se ato luajnë rol të madh në ndërtimin e personalitetit të fëmijëve. Viteve të fundit ministër,

buxheti për ndërtimin e çerdheve ka rënë dhe numri i çerdheve private po rritet. Bazuar në informata zyrtare në çerdhet publike në Kosovë ka vend vetëm për 3% të fëmijëve.

Zoti ministër, çka po ndërmerr MASHT-i për t'i vënë në mbikëqyrje çerdhet private dhe a ka planifikuar ministria që të ndajë më shumë mjete për të ndërtuar çerdhe të reja publike?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, deputet Kurteshi!

Në sferën e arsimit para fillor, Ministria e Arsimit ka tri prioritete: prioriteti i parë gjithë përfshirja rritja sa më e madhe e numrit të çerdheve publike dhe zhvillimin e një kulture familjare për dërgimin e fëmijëve në kopshte publike. Prioriteti i dytë hartimi i një kurrikule për fëmijët nga 0 deri në moshën 6 vjeçare specifikuar për vite, për moshën 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 për secilin vit një kurrikulë dhe e treta përgatitje e mirë e edukatorëve për edukimin e fëmijëve para fillorë.

Jemi në proces të bashkëpunimit me Karitasin zviceran dhe do t'i ndërtojmë tani çerdhet model me mësimdhënës model. Tek sektori privat më lejoni t'ju theksoj se kemi 62 çerdhe private të licencuara dhe kemi 27 në proces dhe 25 janë refuzuar nga Ministria e Arsimit. Poenta e pyetjes suaj ishte mbikëqyrja e çerdheve, sa çerdhe po mbikëqyren dhe a mund të rriten fondet.

Ministria e Arsimit ka standarde të licencimet për çerdhe dhe ju thash që ne nga 27 kërkesa sa kemi sivjet 25 kemi refuzuar, por e pranojmë se ka çerdhe ilegale në ambiente familjare dhe ne po punojmë që tani përmes Ligjit për inspektoratin që është në hartim e sipër të trajnojmë dhe të përgatisim inspektorë të specializuar për kopshte, të cilët do të marrin detyrë që t'i monitorojnë këto çerdhe, të zbulojnë çerdhet ilegale, të palicencuara, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës t'i mbyllin këto çerdhe, kurse çerdhet e licencuara t'i monitorojnë sa janë standardet e plotësuara. Kështu që në vazhdimësi Ministria e Arsimit do të shtojë mbikëqyrjen përmes njësisë së inspektoratit.

Fondet për çerdhe janë të vogla, fondet për çerdhe duhet të ngrihet kjo është një detyrë e komunave, është detyrë e drejtorive komunale që brenda grandit specifik të ndajnë sa më shumë në radhë të parë fonde për çerdhe publike. Ministria dhe Qeveria është e interesuar të ndërtojë sa më shumë çerdhe publike, ne nuk mund të ndalojmë çerdhet private, por ne mund t'i monitorojmë, mund t'i ndërtojmë standardet se çka quhet në Kosovë çerdhe para fillore, kështu që duhet të punojmë së bashku që vërtetë jo vetëm të ndajë fonde, jo vetëm të punojmë në kurrikulë dhe në përgatitje të mësimdhënësve, por të punojmë edhe në ndërtimin e një kulture familjare që fëmijët duhet të qohen në kopshte.

Është e vërtetë se kapacitetet janë të vogla po këtu edhe komuniteti i prindërve mund të kontribuojë, sepse tek çerdhet private prindërit kanë një ndikim të rëndësishëm që brenda lagjes të ndërtojmë një çerdhe dhe ajo çerdhe të bëhet një institucion që mbikëqyret nga prindërit. Brenda projekteve të partneritetit privat o publik mund të shkojmë te ndërtimi i çerdheve, komunitete në bashkëpunim me autoritetet komunale mund të krijojnë fonde të përbashkëta, mund të ndërtojnë çerdhe dhe mund të monitorojnë gjithë kohën standarde dhe funksionimet e këtyre çerdheve.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shitesë, zoti Kurteshi?

ISMAJL KURTESHI: Po! Zoti ministër, kush do t'i kontrollojë çerdhet private të licencuara deri në momentin kur ju do të përgatitni inspektorë të veçantë për çerdhe, sepse s'keni për t'i përgatitur ata për një javë, as për një muaj dhe çështja tjetër është sa çerdhe ilegale i ka mbyll inspektorati i Ministrisë së Arsimit deri në këtë moment? Faleminderit!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: I nderuar deputet Kurteshi!

Edhe me kornizën aktuale ligjore kompetente për t'i monitoruar çerdhet është Ministria e Arsimit, përkatësisht divizioni i inspektoratit, por duhet ta pranoj unë jam i pakënaqur me këtë mbikëqyrje që ka ekzistuar deri më tani dhe tani jemi duke punuar në riformimin e inspektoratit në krijimin e inspektorëve të specializuar për segmente të caktuara të edukimit, jo një inspektor që dinë gjithçka dhe që nuk dinë asgjë.

Por, dëshirojmë të kemi një inspektor të specializuar për çerdhe, për shkolla fillore, për universitete, për universitet, për aspekte pedagogjike dhe të jeni të sigurt se ky proces do të përfundojë sivjet. Ju do ta keni në sesionin e parë të shtatorit Ligjin për inspektoratin dhe do t'i vëreni ndryshimet. Ne kemi mbyll 25 çerdhe, 25 çerdhe i kemi mbyll dhe do të vazhdojmë t'i mbyllim në mënyrë të veçantë do të vazhdojmë t'i mbyllim në shtator kur krijojmë tre inspektorë të specializuar. Nuk duhet më shumë se tre inspektorë në Republikën e Kosovës që janë specialistë për t'i parë standardet e çerdheve dhe për t'i mbyll, sepse një çerdhe pa standarde mund të ndikojë shumë keq në familje, mund të ndikojë keq në edukimin e fëmijëve sepse ne kemi pa në media dhe storie të përdorimit të dhunës ndaj fëmijëve në çerdhe dhe menjëherë kemi reaguar dhe menjëherë i kemi mbyll ato çerdhe ju siguroj se me miratimin e Ligjit për inspektoratin do ta kemi një njësi të veçantë të specializuar të përbërë prej 3 inspektorë, të cilët do të jenë të specializuar kryesisht për monitorimin e standardeve në çerdhet publike dhe në çerdhet private.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Skënder Hyseni. Zoti Haradinaj, dëshironi ta bëni pyetjen?

DAUT HARADINAJ: Po, kryesues! Faleminderit!

Edhe pse ministri nuk është këtu pyetja ka të bëjë që unë mendoj nëse edhe e sheh televizionin ose edhe e merr transkriptin, njëjtë do të ishte, pyetja për ministrin Skënder Hyseni ka të bëjë rreth Ligjit për pensionimin e Policisë së Kosovës meqenëse është edhe kryeministri këtu edhe kjo punë është edhe e ekzekutivit jo vetëm edhe e ministrit, është një çështje shumë urgjente edhe unë po i jap shumë shkurtë disa statistika pse është me rëndësi që të përfundohet ky ligj mbi moshën 40 vjeçare i kemi 4 mijë e 200 pjesëtarë të Policisë. Mbi moshën 46 vjeçare i kemi 2 mijë e 901, mbi moshën 55-vjeçare i kemi 969, kjo i bie që duhet urgjentisht Ligji për pensionimin e parakohshëm i policisë i cili e rregullon sektorin edhe normën ndërkombëtare ku nuk mundet një polic ta ushtrojë detyrën në këtë moshë, domethënë mbi 55 vjet.

Dhe, një ligj i tillë nuk ka shumë implikime buxhetore, por do ta zgjidhte këtë problem. Dje, fatmirësisht, domethënë edhe organizatat e huaja e vlerësuan policinë tanë ndër më të mirat në rajon edhe ky është lajm i mirë mendoj për krejt Kosovën ne duhet t'i përgëzojmë policinë por një të njëjtën kohë edhe tu japim mundësinë ligjore që të trajtohen këta. Këta nuk kanë as

sigurime pensionale, nuk kanë as sigurime shëndetësore, nuk kanë as sigurime aksidentale, do të thotë ky ligj i rregullon këto kritere dhe është në të mirën e Kosovës që sa më shpejt të vijë ky ligj.

Kisha pas dëshirë edhe për opinion publik se dje u spekulua që qytetarët e Kosovës marrin pjesë në luftëra të huaja mbi 300, drejtori i policisë raportoi se ekziston një listë ku janë 100 persona, të cilët marrin pjesë në luftëra fetare jo 300 pjesëtar dhe Kosova pa të drejtë renditet në vendin e katërt si vend donator i ekstremizmit fetar.

Edhe shefi i policisë dje nuk tha që Kosova është e ekspozuar ose është e rrezikuar prej sulmeve, por tha nuk jemi imun në rast se hipotetakisht mund të ndodhë diçka ne i kemi marrë masat që qytetarët të ndihen të sigurt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bali Muharremaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Më 16 korrik është bërë rishikimi i buxhetit të Republikës së Kosovës dhe janë përafërsisht rreth 52 milionë euro më pak në arkën e shtetit. Ndërsa, ju zoti kryeministër gjatë fushatës elektorale keni premtuar rritje të buxhetit deri në 500 milionë euro për çdo vjet. Pyetja: çka po ndodh me premtimet e juaja? A është dështim i radhës i Qeverisë tuaj, të cilën po mundoheni ta kaloni në heshtje?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti deputet!

Faleminderit, kryesues!

Natyrisht se më së pakti mundet buxheti të kalojë në heshtje për arsye se javën e kaluar ne kemi diskutuar mjaftë shumë për buxhetin edhe për amendamentet në buxhet, një javë më parë kemi diskutuar lidhur me strukturën e ndryshimeve dhe plotësimeve të buxhetit të Republikës së Kosovës dhe po ashtu i kemi prezantuar edhe mundësitë e buxhetit.

Edhe unë këtu si kryeministër kam deklaruar se buxheti mund të rritet në qoftë se ne i rrisim taksat dhe tatimet si pjesëmarrje në buxhet. Mund të rritet përmes borxhit publik qoftë të brendshëm apo të jashtëm, mund të rritet po ashtu edhe përmes shitjes së asetëve qeveritare që, për fat të keq, ne kemi pjesëmarrje shumë pak sepse ato mjete janë në mirëbesim dhe nuk shkojnë drejtpërdrejtë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ne e kemi bruto produktin vendor apo GDP-në në vlerë prej 5,5 miliardë euro dhe kemi një pjesëmarrje rreth 30% të tatimeve apo të hyrave fiskale në bruto produktin vendor. Dhe, neve do të na nevojitej një GDP prej 7 miliardë eurove në mënyrë që ta rritim buxhetin për 500 milionë euro nga të hyrat vendore që do të thotë lypet kohë sepse buxhet i tillë mund të rritet vetëm mbi bazën e zhvillimit ekonomik. Ne tani kemi marrë masa me lejen e Fondit Monetar Ndërkombëtar që të kemi leje për ndryshimin e rregullave fiskale, të cilat na mundësojnë që ne të hyjmë në borxh për investime kapitale. Dhe ne i kemi disa prej këtyre programeve të identifikuar, për

shembull kemi rreth 200 milionë që mendojmë ta rritim kapacitetin buxhetor për investimet kapitale për rekonstruktimin e hekurudhës, por jo vetëm për një vit po për më shumë vite.

Kemi po ashtu pëlqimin e bankës evropiane për rindërtim dhe zhvillim për ndërtimin e hidrosistemit për ujitje që po ashtu do të jetë rritje e buxhetit por gjitha këto do të bëhen në bazë të projekteve konkrete e jo që ne të hyjmë në borxh e pastaj të shohim se ku do t'i shpenzojmë këto mjete, do të thotë buxheti do të rritet por politikat e buxhetit janë politika të cilat ne i kemi prezantuar këtu me programin qeverisës. Në program qeverisës nuk kemi dhënë kuantifikime numerike dhe të themi që buxheti do të rritet kaq, atë program e kemi aprovuar si Qeveri i cili ka të bëjë me përkrahjen e politikave të tatimeve të ulëta mirëpo të zgjerimit të bazës tatimore. Prandaj, nuk është punë që ne po kalojmë heshtur, është punë që ne po diskutojmë të gjitha këto në Kuvend dh epo ashtu ka mundësi të rritjes së buxhetit por të rritjes vetëm tash për tash më tepër vetëm me krijimin e borxhit të brendshëm apo të borxhit të jashtëm publik për projekte konkrete jo për rritje të buxhetit, i cili nuk është i adresuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Muharremaj?

BALI MUHARREMAJ: Po, zoti kryeministër nuk kemi nevojë për ligjërata, ju keni premtuar se për secilin vit të qeverisjes do të rritni buxhetin për 5 milionë euro ju që nuk i keni rritur të hyrat por i keni zvogëluar ato në parashikimet e buxhetit të mirëfilltë të këtij viti, njerëzve iu keni premtuar 120 mijë vende të reja të punës, keni premtuar zhvillim ekonomik, ju jo që nuk po na jepni shenja që do të ndodh kjo se do të realizohen premtimet se buxheti do të rritet për çdo vit nga gjysmë miliardi euro, por më keq buxheti i Qeverisë tuaj po minusohet për çdo vit.

Kryeministër, a mundeni ju ose dikush nga qeverisja e koalicionit tuaj ta konfirmoni hapjen qoftë edhe të një vendi të ri të punësimit në Kosovë duke përjashtuar fabrikën e mallit të punësimit, administratën publike që keni dërguar numrin deri te 91 mijë punëtorë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, edhe një herë e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: natyrisht se nuk është qëllim i imi të mbajë ligjërata, mirëpo si duket ke nevojë për ligjërata sepse në qoftë se nuk kishim pasur nevojë atëherë nuk mundesh me prit që 500 milionë t'i bie dikush prej qiellit edhe ta shton buxhetin për gjysmë viti me 500 milionë.

Prandaj, buxheti nuk krijohet në mënyrë fiktive, buxheti krijohet mbi baza reale. Unë po flas bazat reale të krijimit të buxhetit dhe ato janë bazat reale të cilat unë i prezantova këtu jo si sistem të ligjëratave, por si sistem të informimit dhe të përgjegjësisë sime që të informoj ty si deputet, edhe pse je i informuar në seancën e kaluar për arsye se e ke pasur buxhetin përpara.

Sa i përket punësimit, ajo është pyetje e re atë pyetje mund ta bësh herën tjetër unë përgjigjem vetëm në pyetjen e cila është shtruar.

KRYESUESI: Faleminderit! Mendoj që kohën e kemi shteruar. Deputeti i fundit është Mytaher Haskuka pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Nëse jeni për ta vazhduar dhe për t'i përfunduar pyetjet unë e vazhdoj s'e kam problem por sipas Rregullores ne e kemi përfunduar.

MYTAHER HASKUKA: Çështja implementimi i Ligjit NR. 04/ L 054 për statusin me të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre.

Sipas këtij ligji anëtarët e ngushtë të familjes së dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligj realizojnë këto të drejta dhe beneficione, si në nenin numër 5, të drejtën për pensione familjare, neni nr. 6 beneficionet e veçanta dhe beneficionet e tjera të përcaktuara me ligj. Sipas po të njëjtit ligj në fuqi neni 8, paragrafi 2 këtë të drejta i realizon edhe të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike. Pyetja: pse asnjë nga dëshmorët e kombit të rënëve para vitit 1998 nuk është në listën e dëshmorëve dhe familjet e tyre nuk gëzojnë të drejtat që iu garantohet sipas ligjit në fuqi?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Tash unë e kam këtu një një faqe e gjysmë të shkruara prej edhe prej këshilltarëve të mi juridik edhe prej komisionit qeveritar i cili është marrë me këto punë, por unë do t'i bie më shkurtë kësaj, do të thotë përgjigjja është sepse ligjet të cilat janë në fuqi e mundësojnë vetëm këtë si ka vepruar komisioni. Në qoftë se dëshirojmë ta zgjerojmë periudhën atëherë duhet t'i ndryshojmë ligjin.

Në qoftë se ka ankesa individuale ligji e mundëson që ankesat të bëhen dhe që e drejta të fitohet mbi këto ankesa.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

MYTAHER HASKUKA: Zoti kryeministër, sipas ligjit unë e citova ligjin domethënë sipas ligjit në fuqi neni 8 paragrafi 2 po e citoj prapë ligjin, domethënë nuk është kurrëgjë tjetër: këto të drejta, domethënë të gjitha të drejtat të cilat i kanë familjet e dëshmorëve paragrafi 2 thotë, po e lexoj njëjtë ligjin: këto të drejta i realizojnë të gjitha familjet e dëshmorëve të kombit të rënë në forma të ndryshme për lirinë e vendit në periudha të ndryshme historike, që do të thotë edhe para '98-ës këtu s'ka nevojë për ndryshim të ligjit, po mendoj edhe sipas diskutimit me këto familje të cilat të dëshmorëve para '98-tës ndër to, familjet e Fadil Vatës, Afrim Zhitisë, Ylfete Humollit, Rexhep Malës e Nuhi Berishës, por edhe vëllezërit Gërvalla e Kadri Zeka nuk po konsiderohen si dëshmorë të kombit, që është një absurd. Edhe nëse shikojmë të gjithë numrin e tyre, janë diku rreth njëqind e kat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Isë, kryeministër e keni fjalën. Sa për sqarim, dihet statusi i dëshmorit cili është dhe kujt i takon, ata që nuk kanë vdekur duke luftuar s'mund të jenë dëshmorë, ata që kanë vdekur në spital nuk mund të jenë dëshmorë. Zoti Isa Mustafa e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Unë prapë po lidhem me ligjet. Ai që të konsideron, në të vërtetë ne kemi respekt të madh për familjet dhe për të gjithë ata që kanë rënë dëshmorë për

Kosovën. Mirëpo, çdonjëri prej tyre të drejtën e vet mund ta realizojë sipas ligjit. Çdonjërit që i takon me ligj, do ta realizojë këtë të drejtë, por jo jashtë saj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Koha për pyetje parlamentare ka kaluar. Lexojeni Rregulloren. Pika e tretë e rendit të ditës është:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

E ftoj ministrin e Kulturës, zotin Shala, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

(Ndërprerje e incizimit)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.)

KRYETARI: Nait, paraprakisht fjalën e ke, para se ta marrë ministri.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Për rend të ditës deshëm një pikë për ta përfshirë. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport dhe Diasporë e ka prurë një vendim të Komisionit për Këshillin për Trashëgimi Kulturor dhe ky këshill dy herë ka qenë pjesë e votimit jo të mjaftueshëm, prandaj ka mbetur edhe njëherë si komision kemi kërkuar që ta biem si kërkesë dhe të votohet.

Kosova duhet të jetë pjesë e UNESCO-s dhe nëse nuk votohet ky këshill, në shtator nuk kemi mundësi të jemi pjesë e organizmit ndërkombëtar të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Prandaj, po kërkoj nga ju që ta vëmë si pikë të rendit të ditës dhe të jetë pjesë e votimit të Këshillit, sepse Kosova mbetet jashtë kësaj për një vit tjetër, jashtë Këshillit të UNESCO-s. Faleminderit!

KRYETARI: Naiti e ka bërë një propozim konkret. Ne po shkojmë në votim formal. Duhet shumica e thjeshtë. Shkojmë me votim elektronik apo formal? Formal. Hajde vetëm ngritëm duart kush është për. E konsideroj pikë të futur në rend dite, pikën e rendit të ditës të radhës. Administrata, ju lutem na i sillni materialet. Pas kësaj pike, pika e katërt e rendit të ditës të futet ajo.

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim, në parim.

E ftoj ministrin e Kulturës, zotin Kujtim Shala, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Zoti kryetar,

Zoti kryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,

Me qëllim të rritjes së standardeve për fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e përkushtuar që të krijojë dhe zhvillojë politika, të cilat do të jenë në funksion të përmbushjes së objektivave ligjore në këtë rrafsh. Në kontekstin e obligimeve ligjore, duke përcjell legjislacionin ndërkombëtar të fushës dhe në bazë të përcaktimit të Qeverisë për përafrimin e legjislacionit të Kosovës, me legjislacionin e Bashkimit Evropian, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka ndërmarrë veprime me qëllim të transpozimit të AQUI-së së Bashkimit Evropian për të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta.

Në këtë drejtim duhet të theksohet edhe Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, nga e cila do të dalin obligime për Republikën e Kosovës, që të ofrojë mbrojtje për të drejtat pronësore intelektuale në nivel të njëjtë me vendet e Bashkimit Evropian.

Në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta ekzistojnë disa direktiva të BE-së, me të cilat shtetet anëtare kanë bërë harmonizimin e legjislacionit të tyre, respektivisht në legjislacionin për të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta në kontekstin e Bashkimit Evropian dhe atë ndërkombëtar, në vijimësi bëhen ndryshime dhe për këtë shkak është parë e nevojshme, që të bëhen plotësime dhe ndryshime të Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta.

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta, përmban 33 nene, me të cilat synohet të plotësohet dhe ndryshohet Ligji bazë për të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta, i cili ka 206 nene, me qëllim të normimit sa më adekuat të fushës së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

Në këtë kontekst, Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta duhet të plotësohet dhe ndryshohet me qëllim harmonizimin e tij me direktivat e BE-së së kësaj fushe, në çështjet dhe dispozitat lidhur me mbrojtjen e programeve kompjuterike, respektivisht çështjen e objektit të mbrojtjes, qiradhënien dhe huadhënien e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. Gjithashtu, ky ligj rregullon të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta, të cilat aplikohen në transmetimin satelitor dhe ritransmetimin kabllor, rregullohet edhe kohëzgjatja e të drejtave të autorit në rastet e veprave muzikore dhe të kompozuar me fjalë dhe zgjatet afati i mbrojtjes për të drejtat e përafërta të interpretuesve dhe të prodhuesve të fonogrameve nga 50 në 70 vjet.

Ligji rregullon edhe procedurën e sigurimit të provave dhe të aplikimit për masa të përkohshme dhe paraprake nga mbajtësit e së të drejtave, përfshirë këtu edhe mundësinë e mbrojtjes së të drejtave të vetë autorit lidhur me personat që mund të aplikojnë për masat e parapara juridike, si dhe llojet e mjeteve juridike, duke ofruar mjete bashkëkohore juridike për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

Me ndryshimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtave të përafërta, Republika e Kosovës do të ketë një ligj adapt për fushën e të drejtës së autorit dhe do të krijohet infrastruktura ligjore e domosdoshme për krijimin e një sistemi funksional të mbrojtjes së të drejtave të autorit, të cilat do të mbrohen dhe respektohen duke ndikuar në rritjen e kreativitetit dhe krijimeve kulturore, në përgjithësi.

Unë dëshiroj të theksoj shkurt, direktivat të cilat janë marrë për bazë në ndryshimet të cilat propozohen:

- direktiva mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta;
- direktiva për përdorimin e lejueshëm të veprave pa autorësi dhe pronar të njohur;
- direktiva mbi harmonizimin e disa aspekteve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në shoqërinë e informacionit;
- direktiva për lehtësimin e transmetimit ndërkufitar të programeve audio-vizuale, përkatësisht transmetimit me satelit dhe ritransmetimit kabllor;
- direktiva për të drejtën e rishitjes, respektivisht për fitimin e autorit të një vepre origjinale të artit, e cila ka për qëllim balancimin e interesave të autorëve dhe pronarëve të veprave artistike;
- direktiva për mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave;
- direktiva për harmonizimin e legjislacionit në lidhje me të drejtat mbi qiradhënien dhe huazimin;
- direktiva që ka harmonizuar legjislacionin evropian në lidhje me mbrojtjen e programeve kompjuterike; dhe
- direktiva për zbatimin e të drejtave pronësore, intelektuale.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe nevojën e avancimit të fushës së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në Republikën e Kosovës, unë ju ftoj që të votoni dhe të miratoni sot në parim Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Ftoj tani kryetarin e Komisionit FunkSIONAL, zotin Nait Hasani, pasi kemi pasur veç prezantimin e projektligjit. Urdhëro, Nait!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e të drejtave të autorit, në mbledhjen më 15.7.2015 dhe i rekomandon seancës plenare, që të miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

I propozojmë që në parim të kalojë ky projektligj dhe jemi të gatshëm që me amendamente t'i ndryshojmë, ose t'i plotësojmë pjesët për të cilat janë dhe duhet. Në komision ka pasur debate për këtë ligj dhe ka debate, sepse shtetet e BE-së dhe shtetet e përafërta të Ballkanit kanë forma të ndryshme të organizimit të mbrojtjes së të drejtës së autorit. Unë vetëm po e cek se lajmet ditore janë të pambrojtura dhe ato janë portalet e ndryshme, të cilat bëjnë edhe keqpërdorime po ashtu, të informatave të ndryshme, duke u prezantuar si autorë të vetët, pa qenë asnjëherë autorë.

Ndërsa, Franca e ka të mbrojtur më së miri këtë formë dhe të gjitha veprat, të cilat janë të mbrojtura, ose veprat e autorit. Prandaj, kërkoj që në parim të kalojë, pastaj në komision do ta shqyrtojmë dhe plotësojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Nait! Deklarohemi në emër të grupeve parlamentare. E ka fjalën Bekim Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike në parim i jep mbështetje plotësim-ndryshimit të Ligjit për të drejtat e autorit. Duke pasur legjislacionin për të drejtat e autorit dhe direktivat e Bashkimit Evropian për të drejtat e autorit, të cilat në vazhdimësi plotësohen, ka ardhur nevoja që edhe njëherë pas miratimit të këtij ligji në mandatin e kaluar, që tani të plotësohet, për shkak se kanë ndryshuar edhe direktivat e Bashkimit Evropian dhe Parlamentit Evropian për të Drejtat e Autorit, të cilat në vazhdimësi po plotësohen.

Kemi diskutuar edhe në grupin parlamentar, mirëpo edhe në komision, që është e nevojshme që ky ligj të plotësohet dhe ndryshohet, mirëpo është edhe kërkesë e jona që Ministria e Arsimit, sa u përket direktivave të Parlamentit Evropian dhe të tjerat, të rregullojë në një formë me udhëzime administrative në të ardhmen, që me ligj Kosova i pranon dhe i mbështet direktivat e Bashkimit dhe Parlamentit Evropian, mirëpo pastaj që të mos na vijë për çdo vit, sa herë të ndryshohen dhe plotësohen këto direktiva dhe këto objektiva, që mos ta ndryshojmë dhe plotësojmë ligjin, mirëpo kjo pastaj të bëhet dhe plotësohet me udhëzime administrative përbrenda ministrisë, që të mos kemi në vazhdimësi nevojë, që Ligjin për të drejta të autorëve ta plotësojmë e ta ndryshojmë në vazhdimësi.

Në parim, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje këtij plotësim-ndryshim të ligjit dhe i ftoj edhe të gjithë deputetët, për arsye se kemi edhe deputetë që janë edhe krijues, kanë edhe vepra letrare e artistike, që kontributin e tyre ta japin gjatë amendamentimit të ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Salih Morina, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit!

I nderuar kryeministër,
Ministra,
Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Projektligjin për të drejtat e autorit dhe ne jemi pajtuar, që në parim ta mbështesim këtë projektligj. Mund të ketë disa modifikime në disa nene, por besoj që gjatë leximit të dytë edhe Komisioni për Arsim, njëkohësisht edhe Ministria e Kulturës si sponsorizues, do t'i rregullojnë disa nene. Vlen të theksohet neni 45, ku parasheh që organizatat transmetuese, pa lejen e autorit dhe mbajtësve të tjerë të drejtave dhe pa kompensim mund të bëjnë incizime.

Por, mendoj që bashkërisht këtu edhe me ministrin, gjatë leximit të dytë mund ta rregullojmë edhe këtë nen edhe disa nene të vogla dhe po ashtu, në fjalën që e tha edhe kolegu deputet Nait Hasani, kemi sot shumë portale në Kosovë të cilave nuk u dihet autori, por besoj që me udhëzime administrative edhe këto çështje mund të mbulohen dhe mund të rregullohen.

Prandaj, ftoj të gjithë deputetët e parlamentit të Kosovës, që ta votojnë në parim Projektligjin për të drejtat e autoriale, sepse është i një rëndësie të veçantë edhe për vetë Ministrinë, por njëkohësisht edhe për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismail Kurteshi nga “Vetëvendosja” e ka fjalën.

ISMAIL KURTESHI: Faleminderit!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” i ka shqyrtuar 33 nenet, që janë propozuar për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për të drejtat e autoritetit dhe të drejtat e përafërta nga Ministria e Kulturës me qëllim të harmonizimit të këtyre neneve me legjislacionin në fuqi në Bashkimin Evropian, por edhe plotësimin e nevojave, të cilat po lindin se rezultat i zhvillimit dinamik në këtë lëmë.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do t’i përkrahë në parim ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji, por në periudhën në mes të dy leximeve, do të analizojmë propozimet, do të japim kontributin konkret në avancimin e ndryshimit dhe plotësimit të këtyre neneve. Do të konsultohemi, sidomos në nenet që rregullojnë të drejtën e autorit në pronësinë intelektuale, që u takon krijuesve dhe në fushën e artit, shkencës dhe të letërsisë dhe të drejtën e përafërt, që u takojnë interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve, producentëve të filmit dhe shërbyesve medialë, audio-vizualë e kështu me radhë...

Do të shikojmë me kujdes gjerësinë dhe limitet e trashëgimisë të të drejtave, shtrirjes dhe kufizimit të shfrytëzimit dhe të këtyre të drejtave. Edhe definimi i menaxhimit kolektiv të të drejtave autoriale, që do të mundësojë edhe themelimin dhe funksionimin e shoqatave për administrim kolektiv është pjesë e rëndësishme e projektligjit, që duhet të rregullohet me kujdes.

Në fund, kam një vërejtje serioze për Ministrinë, që të ketë kujdes, që kur ta sjellë versionin final, të jetë një përkthim shumë më cilësor, se që ka pru në dokumentet që i ka pru komisionit, sepse ai përkthim është për çdo kritikë dhe jo vetëm që nuk bën të jetë në dokumentin final, por edhe në këtë pjesën që e ka pru ndikon në kualitetin e punës së Komisionit dhe të tjerëve, sepse ka shumë çështje të cilat nuk kuptohen drejt, për shkak të përkthimit, që është sjell jo ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën Teuta Haxhiu nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe e përkrah në parim. Do të punojmë në punën në grupe për të dhënë maksimumin, që ky ligj të jetë sa më funksional për implementim.

E kemi përmendur edhe brenda Komisionit, se me të vërtetë ka një volum shumë të madh ky ligj edhe në mandatin e kaluar këtu kanë qenë pak a shumë vërejtjet tona, por do të mundohemi që ta bëjmë sa më të implementueshëm.

KRYETARI: Faleminderit! Slavko Simiq nga Liste Serbe e ka fjalën.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Parlamentarna grupa Srpske liste u načelu podržava nacrt zakona o izmeni i dopuni Zakona o autorskim pravima i mi ćemo svoj doprinos oko izmena i dopuna ovog zakona dati kroz funkcionalne i stalne komisije u kojima su poslanici Srpske Liste zastupljeni. Hvala!

KRYETARI: E ka fjalën Shukrije Bytyqi nga “Nisma”.

SHUKRIJE BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar Nisma për Kosovën e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësimin e ndryshimin e të drejtave të autorit dhe të drejtat e përafërta dhe në parim i jep mbështetje, ndërsa kontributin tonë do ta japim gjatë leximit të dytë dhe në punën e komisionit përkatës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fikrim Damka nga “6+”-i e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah, në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Agim Aliu e ka fjalën.

AGIM ALIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pronësia intelektuale e ka një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin dhe avancimin e kulturës, shkencës dhe teknologjisë së një vendi. Ne duhet të shohim pronësinë intelektuale si një mjet e katalizator të zhvillimit kulturor, shkencor dhe ekonomik dhe përmes avancimit dhe mbështetjes së krijimtarisë intelektuale, kreativitetit dhe inovacionit të nxisim zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Duke pasur parasysh që pronësia intelektuale, përkatësisht të drejtat pronësore intelektuale kanë një rol shumë të rëndësishëm në kohën tonë, kur neve jemi të rrethuar me objekte të cilat janë të krijuara falë inovacioneve dhe ideve të materializuara, duke filluar nga telefonat e mençur, që çdonjëri nga ne ka në posedim, të cilët janë të mbrojtur në të drejta pronësore, industriale, patenta dhe marka tregtare e deri tek librat e romanet, për të cilët është investuar shumë kohë dhe mund për t’i krijuar e që mbrohen me të drejtën e autorit.

Në këtë kontekst, e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta si degë e pronësisë intelektuale duhet të normohen dhe të rregullohen me ligj, përkatësisht dispozita ligjore, të cilat fillimisht u njohin të drejtat autorëve përkitazi me veprat e tyre dhe titullarëve të të drejtave të përafërta dhe përcaktojnë mjete juridike për mbrojtjen efikase të këtyre të drejtave, duke përcjell zhvillimet ligjore në vendet e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ku të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta mbrohen me fanatizëm.

Përcaktimi për dispozitat ligjore, që rregullojnë fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtat e përafërta duhet që gjithmonë të kenë si pikënisje dhe t'i përshtaten realitetit tonë ekonomik dhe shoqëror, marrë parasysh gjithherë konventat ndërkombëtare të fushës për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta me theks të posaçëm direktivat e Bashkimit Evropian, që e rregullojnë këtë fushë.

E drejta e autorit duhet të shërbejë si bazë dhe pikënisje e krijimtarisë shkencore, letrare dhe artistike, ku krijuesit, shkrimtarët dhe shkencëtarët tanë duhet të kenë parasysh çdoherë, që krijimet e tyre të jenë origjinale dhe të jenë krijime intelektuale të mendjes dhe dijes së tyre. Duke respektuar të drejtën e autorit konkretisht në çdo punim dhe krijim të tyre të krijuar bazuar në veprat e autorëve të tjerë, të citojnë ata autorë dhe të njohin kontributin e tyre, në të kundërtën kemi të bëjmë me plagjiaturë, dukuri kjo që është pengesë e zhvillimit shoqëror, kulturor dhe ekonomik të vendit tonë.

Pra, rol të rëndësishëm duhet dhënë aplikimit të normave juridike, pjesë e legjislacionit pozitiv të së drejtës së autorit, me qëllim të luftimit të shkeljeve të së drejtave të autorit dhe luftimit të piraterisë. Vetëm duke zbatuar ligjin për të drejtat e autorit mund të ketë një zhvillim të krijimtarisë artistike, shkencore dhe të kulturës në përgjithësi, përfshirë këtu zhvillimin e industrive kreative dhe mediave të shkruara dhe elektronike, së bashku me radio dhe televizione.

Zbatimi i ligjit sjell kompensim të drejtë dhe të merituar për krijuesit, autorët, shkrimtarët e shkencëtarët dhe është imperativ i kohës dhe drejtim i duhur i së ardhmes.

Duke pasur parasysh që Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta ka për qëllim harmonizimin e Ligjit aktual për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta me legjislacionin ndërkombëtar e posaçërisht evropian të fushës, mbështes në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës, Natyrisht, që ky është një ligj i cili mbron njërën nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut, që është e drejta e pronësisë intelektuale dhe kjo e drejtë, le të themi, ndërtohet mbi një trekëndësh të caktuar, që është autori i veprës, që prodhon pronësinë intelektuale, që është blerësi i të drejtave mbi shitjen apo përdorimin e veprës, e cila është prodhuar nga autori dhe në fund është publiku, që e konsumon këtë produkt.

Por, deri sot në Kosovë ka qenë shumë i favorizuar blerësi i të drejtës për shitjen dhe përdorimin e veprës, por ka qenë në përgjithësi apo fare i pambrojtur autori, që e prodhon këtë vepër.

Në Kosovë për këtë arsye ka qenë shumë e shprehur kjo dukuria e plagjiatit, dukuria e plagjiaturës apo vjedhjes së pronësisë intelektuale. Duke filluar prej librave universitare deri tek CD-të e muzikës nëpër rrugë, autorët janë dëmtuar dhe shumë prej tyre nuk kanë mundur kurrë t'i mbrojnë të drejtat e tyre, sepse të drejtën e autorit nuk e mbron autori, ai është i pafuqishëm si individ ta mbrojë të drejtën e vetë. Të drejtën e autorit e mbron shteti, sepse shteti është i thirrur

që të veprojë përbrenda këtij trekëndëshi, që është autori, blerësi i të drejtës për shfrytëzimin e veprës dhe në fund publiku, që e konsumon atë vepër.

Dhe, mund të them që deri sot në Kosovë shteti nuk ka qenë proaktiv në kapjen e shkelësve. Kjo e dëmton shumë prodhimtarinë intelektuale, sepse mospërmshja e kësaj të drejte është armiku më i madh i krijimtarisë intelektuale, sepse krijimtaria intelektuale nuk e ka, le të themi, vetëm atë komponentin e përmshjes apo të satisfaksionit shpirtëror të autorit, sepse ai nuk prodhon vepra vetëm që ato të kontemploten apo të shfrytëzohen prej publikut, por mos të harrojmë një gjë, autori edhe jeton prej punës së vet. Ai duhet të jetojë prej veprave të tij. Shumë autorë e kanë të vetmin burim të jetesës krijimtarinë e tyre intelektuale, artistike, kulturore e kështu me radhë... dhe, nëse shteti nuk është në mbrojtje të këtyre njerëzve, të kësaj të drejte shumë të çmuar, atëherë, me thënë të drejtën, i vendos vetë autorët në një rrafsh të papëlqyeshëm kur ata detyrohen të shkelputen prej asaj që është, le të themi, përmshje e tyre shpirtërore dhe të detyrohen të punojnë punë të tjera, siç në Kosovë ndodh shumë shpesh bile.

Ndodh që shoh ti krijues artistik, krijues intelektualë në lloj-lloj punësh të ndryshme, që nuk janë vokacioni i tyre primar dhe origjinal edhe për çka ata janë shkolluar dhe kjo është me të vërtetë e dhembshme në Republikën e Kosovës. Mirëpo, duhet të ketë një balancim të mirëfilltë në mes interesave të publikut dhe të drejtave të autorit, që është le të themi njëfarë lloji i të drejte private, ai e ka pronë prodhimin e tij, veprën e tij dhe kjo është njëfarë prone private e tij. Mirëpo, ajo e ka edhe një qasje edhe me lidhjen me publikun dhe në këtë mënyrë ajo i përket edhe publikut, është edhe vepër publike në të njëjtën kohë, aq sa është edhe private. Dhe, shteti, ma merr mendja, që duhet të gjejë drejtpeshimin më të mirë të mbrojtjes edhe të të drejtave të publikut, se edhe publiku i ka disa të drejta. Bile, unë mendoj që rregullimi i të drejtës të autorit në të vërtetë nuk është një rregullim i thjeshtë, të cilin shteti e mbron vetëm në mënyrë negative, pra nuk është përgjegjësia e shtetit në mbrojtjen e të drejtës së autorit, vetëm që ta mbrojë autorin, thjesht nga shkelja, predispozimi i tij ndaj kopjimit, ndaj vjedhjes së idesë, e kështu me radhë.

Kjo është një e drejtë, e cila nëse tenton të rregullohet mirë, atëherë shteti i merr edhe disa obligime të caktuara, të cilat lindin në momentin kur shteti mbron në mënyrë strikte të drejtën e autorit. Unë po dua ta prek vetëm një dimension të problemeve që lindin, kur shteti mbron në mënyrë të rreptë, në mënyrë të ashpër të drejtën e autorit. Për shembull, i keni studentët e Universitetit të Prishtinës, unë po i marr vetëm studentët e mjekësisë, sepse ata janë... ata e kanë hallin më të madh me këtë fushë, të jesh student i mjekësisë dhe të bësh shkencë të njëmendtë, në kurrikulumin që ti e ke, për t'u dalë në fund studimeve janë nja 250 libra, nja 300 libra, do atllase shumë të shtrenjta të anatomive e të fiziologjive e të drejtmeve të ndryshme, të cilët më së paku për të qenë kualitativ kushtojnë nga 100 euro dhe këto 250 – 300 libra një student me kapacitetin e tij financiar këtu në Kosovë, nuk është e mundur t'i përballojë dhe t'i blejë të gjitha ato libra.

Edhe e keni pa ju në Kosovë këtë fenomenin e fotokopjimit të veprave të autorëve të ndryshëm, që natyrisht është shkelje e të drejtave të autorit dhe nuk bën të ndodhë, mirëpo në anën tjetër, njerëzit e kanë këtë problem dhe nuk mund ta zgjidhin studentët tanë. Nëse shteti vetëm më thotë mua, nuk më intereson kjo çështje, prej sot duhet të fillojë zbatimi i ligjit dhe punë e madhe për ata studentë pastaj, se si të gjenden. Hajde të fillojmë, mbyllini të gjitha fotokopjet, që e kanë bërë këtë shkelje dhe nëse nuk merret shteti me një kosto që prodhon, për shembull, kjo problematikë në fushën e subvencionimit të përkthimeve, për shembull, apo të librit universitar,

Universiteti i Prishtinës është me përkthimet më të pakta prej krejt universiteteve të Evropës. Nëse nuk i përktheni ato atllase të anatomisë, të mjekësisë, nëse nuk e shtoni fondin nga ana e Qeverisë për t'ia dedikuar Universitetit në mënyrë të veçantë për përkthimin e këtyre librave, unë nuk e di se si do të gjenden ata studentë, nëse ky ligj fillon të implementohet në mënyrë të ashpër dhe ata nuk dinë pastaj kah t'ia mbajnë dhe si të gjejnë zgjidhje.

Gjithmonë zgjidhjet kanë qenë në disa forma, le të themi, pirateske të mënyrave qysh këta njerëz janë furnizuar me libra, sepse gjendja financiare e studentëve tanë nuk e përballon një gjë të tillë.

Pra, unë e përmenda vetëm një aspekt, por ka edhe shumë të tjera, me të cilat duhet të merret Qeveria dhe duhet t'i ketë në trajtim, kur të mendojë për zbatimin strikt dhe absolut të këtij ligji në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër i vendit,

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Plotësim-ndryshimi i Projektligjit për të drejtat e autorit dhe të drejta të përafërta me 33 nenet e tij, mendoj se do të ndihmojë jashtëzakonisht shumë në rregullimin e kësaj fushe, por pajtohem me atë që u tha nga kolegët këtu, se problemet janë shumë të mëdha, prandaj, mendoj se duhet të insistohet në mekanizmat konkretë.

Problemi më i madh është në fushën e mbrojtjes së të drejtës, që lidhet me shoqatat kolektive. Fatkeqësisht, e drejta e autorit vazhdon të jetë njëra prej të drejtave që respektohet shumë pak në Kosovë dhe krahasuar me shumë shtete tjera, do të thotë Kosova qëndron jashtëzakonisht keq në këtë drejtim, përkundër një legjislacioni të mirë, që është munduar të krijohet lidhur me mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Ka pasur shumë probleme, edhe pse ka pasur krijim të task-forcave që janë munduar të krijojnë dhe rregullojnë këtë fushë, po i përmend disa aksione, që janë realizuar nga Policia e Kosovës, nga Inspektorati i Tregut, pastaj nga Zyra për të drejtat e autorit, të cilat janë munduar të kontrollojnë gjithë atë plagjiaturë që është bërë në këtë fushë.

Ajo që për mua si deputete është shqetësuese dhe që u potencua edhe nga kolegu Konjufca, është edhe çështja e fotokopjeve, të cilat veprojnë në Kosovë dhe të cilat bëjnë fotokopjim të teksteve shkollore, pa marrë paraprakisht leje prej autorëve. Diçka që mund të vlerësohet si sinjal pozitiv, është se ka pasur disa raste kur kanë filluar që fotokopjet të marrin autorizim nga autorët dhe mjetet të cilat janë fituar nga këto fotokopje janë ndarë si fitim edhe autorit.

Pirateria digjitale, që u përmend, është shumë me probleme. Janë shumë ueb sajte, të cilat vendosin materialet e tyre që shkelin në mënyrë drastike të drejtat e autorit. Këto ueb sajte do të duhej që të bllokoheshin në tërësi. Në rast se kjo kryhet, atëherë unë mendoj se kjo do të ndikojë edhe në rritjen e numrit të shikueshmërisë nëpër kinematë e Kosovës. E dini që pirateria ka prekur në masë të madhe, do të thotë, këtë fushë. Mendoj që duhet të fokusohemi shumë më

shumë në ndërgjegjësimin e qytetarëve. Ligjet janë të mira, por ajo që mungon është ndërgjegjja e qytetarëve që ka një ligj, i cili mbron këto të drejta dhe këta qytetarë, këta krijues, të cilët bien viktima, ose janë pre e shkeljes së të drejtave të tyre, atëherë mendoj se duhet t'i adresojnë këto raste në instanca të cilat janë përgjegjëse, do të thotë, në rast se këto të drejta shkelen, atëherë të mos hezitojnë që të bëjnë denoncime, qoftë padi, qoftë kallëzime në polici dhe në gjykata, që rregullojnë këtë fushë.

Unë do ta votoj në parim këtë ligj dhe pres që gjatë kohës së amendamentimit ne ta plotësojmë me plotësim-ndryshimet e deputetëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fisnik Ismajli e ka fjalën dhe luten deputetët të futen në sallë, se kemi votim pastaj.

FISNIK ISMAJLI: Të nderuar deputetë dhe të pranishëm,
Unë sot po dua të flas për Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, por jo për ndryshimet dhe plotësimet, që po doni t'i bëni në këtë ligj, gjithmonë me arsyetimin se duhet t'i përcjellim standardet e Bashkësisë Evropiane, po dua të flas për krijuesin.

Duke qenë se vetë jam krijues dhe shpesh i shoh të drejtat e mija duke i keqpërdorë, po dua të flas për atë autorin, për të drejtën e të cilit thoni se tërë kohën po punoni, madje duke përpiluar edhe një ligj, i cili nëse vërtet e lexon, jo vetëm se është goxha mirë i shkruar, por edhe ta jep përshtypjen se krijuesit janë ndoshta, edhe krijesat më të mbrojtura në Kosovë, sot.

Por, realiteti është krejtësisht tjetër. Krijuesit, ata të mirëfilltit, në rastin më të mirë, mezi fitojnë bukë për të ngrënë, e thatë edhe ju parafolësit. Derisa prej punës së tyre përfitojnë stërshitësit dhe ata që merren me pirateri. Të jesh këngëtar që di të këndojë apo aktor i mirë, është pothuajse e kotë në Kosovë sot, sepse vepra jote vlerësohet dhe bëhet pazar për të, sikurse për një kilogram dardhash dhe jo këto dardhat e Isa Mustafës, që janë në shesh, se nuk po flas për shkrimtarin, a poetin, a piktorin, a skulptorin... madje, këtu po dua ta fus edhe programorin, sepse ky ligj prek edhe teknologjinë informative, e cila njëjtë sikur arti e kultura neglizhohen tej mase sot në Kosovë. E ku është problemi?

Problemi është, se ky ligj, ndonëse në parim është i vlefshëm, figuron veç në letër dhe nuk zbatohet, ashtu qysh nuk zbatohen edhe plot ligje tjera dhe ne përfundojmë duke rrejtur vetveten, se kemi ligje me standarde evropiane, e realiteti është se edhe Evropa e sheh se këto ligje nuk jemi duke i zbatuar dhe për këtë arsye vazhdon të na mbajë në izolim.

Sot, edhe pse ligji e definon, ndryshe krijuesi, e po e marr në shembull një këngëtar apo një shkrimtar, është i detyruar t'ia shet veprën një të ashtuquajtur prodhues apo botues, me një çmim fiks, zakonisht shumë të ulët, sepse nuk ka mekanizëm që e kontrollon numrin e transmetimeve të një kënge, për shembull, ose tirazhin e një botimi në mënyrë që të paguhet ashtu si në krejt botën, varësisht sa e lyp tregu.

Në këtë mënyrë, nëse një krijues e shkruan një libër të mirë apo e kompozon një këngë të bukur përfiton aq sa ka futur punë në të, jo aq sa ia ka vlerësuar paraprakisht producenti e që është një çmim zakonisht i ulur, nga i cili ai mundohet të përfitojë veç vetë. Kjo natyrisht ndikon edhe në

cilësinë e krijimtarisë, sepse krijuesin nuk e motivon të lodhet e të punojë më shumë e për të krijuar një vepër më të mirë kur e di se nuk do të ketë bukë prej saj, dhe shumica përfundojnë duke vjedhur, duke modifikuar vepra ekzistuese, duke banalizuar skajshmërisht krijimtarinë në Kosovë.

E po e dëgjoj veten nganjëherë, apo po ju dëgjoj juve duke na thënë neve: po ju të “Vetëvendosjes” veç po kritikoni, por s’po jepni alternativa. Çka po do alternativë më të mirë se për t’ju thënë: zbatoni ligjin. Shumë gjëra janë veç të definuara në këtë ligj, por në praktikë nuk janë kurrkrah. Më shumë i mbron të drejtat e një autori të artistit kosovar You Tube, se sa mekanizmat e zyrtarë e kësaj Qeverie, e si rezultat sot nuk ka art e kulturë të mirëfilltë të teknologjisë informative.

Sot ka shou-biznes të shëmtuar, i cili i ka humbur vlerat, nga i cili përfitojnë më së shumti këta artistët e rremë, të cilët paratë më të mëdha i fitojnë nëpër dasma e syneti, e për të cilat as tatime nuk paguajnë, sepse nuk ka mekanizëm që e zbaton ligjin, derisa krijuesit e mirëfilltë ata të vërtetë, që vërtet krijojnë vepra as nuk i kanë kushtet më themelore të krijojnë, as të promovojnë e në fund as të fitojnë ndershmërisht prej punës së tyre.

Ata të njëjtit pseudo-artistë që përfitojnë më së shumti edhe prej do grandeve e financimeve të Qeverisë, sepse prodhojnë cilësi ekstremisht të ulët që të kenë sa më pak shpenzime dhe atë profitin e madh në fund ta ndajnë me dallaveraxhinjtë brenda në qeveritë që janë, në këtë qeverinë aktuale dhe krejt ato të kaluara. E ju vazhdoni të krenoheni se keni ligje me standarde evropiane, e as idenë më të vogël nuk e keni se sa e fortë është industria kreative, po e zëmë, në Britani të Madhe dhe po dua të marr shembull, e cila më as nuk e quan industri kreative, por e quan ekonomi kreative.

Qe, po e marr një shembull, të ilustroj. Sot në Britani, ekonomia që ka të bëjë me fushat, prej filmit deri te dizajni i rrobave, te programi i aplikacioneve në telefon që i keni deri te lojërat kompjuterike, muzika, media, dizajni, reklamimi, piktura, skulptura e deri te arkitektura, njihet si industria më e rëndësishme që i bie të hyra sektorit kreativ dhe teknologjisë informative, pra të Britanisë së Madhe, me total prej 71 miliardë funtash në vit. Po, po, 70 herë buxheti i Kosovës, të dashur kolegë. E, Ismet Beqirit, i doket sukses kulturor e kreativ kur e pranon në zyre një reper veç të dështuar të Amerikës dhe i cakërron grushtat me to. Njëmend, as grushtet s’ka ditur për t’i cakërruar se ia pati kapur dorën.

Kjo situatë nuk është e pazgjidhshme, përkundrazi në Kosovë ka tepër shumë burime njerëzore që kanë vullnet të jashtëzakonshëm të vendosin drejtësi sociale në mes krijuesve dhe arbitraritetit qeveritar të vazhdueshëm.

Problemi i madh që e pengon këtë vullnet për të dhënë rezultate janë pikërisht politikat e mbrapshta për kulturën, artin e teknologjinë informative nga përfaqësues politikë të PDK-së e të LDK-së të cilët kanë averzion në fakt ndaj artit, kulturës së mirëfilltë, sepse këto vlera shkojnë kundër hajnisë, kundër korrupsionit dhe sigurisht kundër injorancës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kemi mbaruar me deputetët diskutues. Përfaqësuesi i Qeverisë nëse e do fjalën, le të urdhërojë.

Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash!

Është një votë absolute të 74 deputetëve, 74 për dhe Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Kërkohet nga Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme, që në afati ne paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Jemi në pikën e rendit të ditës,

- Emërimi i shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 16 prill 2015, ndërsa në seancën plenare të datës 7 maj 2015 nuk ka marrë pjesë në votim numër i nevojshëm i deputetëve, andaj, në seancën e sotme, duhet të përsëritet votimi.

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi kulturore, si në vijim:

1. Shafi Gashi, shqiptar,
2. Florim Isufi, shqiptar,
3. Arijeta Miftari, shqiptare,
4. Doruntinë Matoshi, shqiptare,
5. Visar Haxhibeqiri, shqiptar,
6. Bego Kululleri, turk,
7. Huljko Jovanoviq, serb.

Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

76 deputetë kanë votuar, 66 janë për, 7 abstenime dhe 3 kundër, konstatoj se Kuvendi zgjodhi anëtarët e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me mandat trevjeçar.

Kalojmë në pikën e pestë:

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për armë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

E ftoj raportuesin e Komisionit Funksional, deputetin Rexhep Selimi, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke analizuar qëllimet e projektligjit, përmbajtjen dhe nevojën për këtë ligj, si dhe rëndësinë e tij, duke vlerësuar standardet dhe hartimet e legjislacionit, përputhshmërinë dhe praktikën legjislative, konstatoi se propozimi i amendamenteve në nenet e cekura, është në favor të rritjes së efektivitetit, të normimit dhe në favor të lehtësimit të zbatimit të këtij projektligji në praktikë.

Propozim amendamentet janë bërë me qëllim të saktësimit dhe rregullimit të dispozitave të projektligjit dhe Komisioni funksional i rekomandon Kuvendit miratimin e Projektligjit numër 05/L-22 për armë, bashkë me amendamentet e propozuara.

Zoti kryetar,

Në përputhje me Rregulloren unë propozoj edhe një amendament të ri që të dalë si amendament i kësaj seance dhe me dakordimin e përfaqësuesve të grupeve parlamentare në Komision dhe me kërkesën e saktë të propozuesit, respektivisht të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për 1 amendament të ri, më lejoni ta lexojë amendamentin me radhë numër 64, për shkak se ky projektligj në lexim të dytë ka 64 amendamente dhe unë propozoj amendament të ri me numër rendor 65, që ka të bëjë me nenin 4 të këtij ligji, pika 1 pikë 1.6.

Për procesverbal, më lejoni ta lexoj kërkesën për ndryshim.

Në vend të “armë zjarri me tytë poligonale A16”, propozuesi kërkon që ky definicion të favorizohet teknikisht më shumë se sa ndryshe “me armë zjarri me tytë poligonale e cila nuk mund të gjurmohet lehtësisht, në kllapa (A-16). Më lejoni ta përsëris edhe një herë ndryshimin e kërkuar nga sponsorizuesi.

Është pika 1.1.16 “armë zjarri me tytë poligonale” kërkohet të amendamentohet në këtë formë, dhe lexoj tekstin: “armë zjarri me tytë poligonale e cila nuk mund të gjurmohet lehtësisht, në kllapa (A-16).

Ky amendament, apo ky ndryshim është i nevojshëm për të lehtësuar zbatimin e këtij ligji si dhe për të mos paraqitur pengesa në zhvillimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me armët.

Pra, edhe në emër të anëtarëve tjerë të Komisionit në konsultë, unë kërkoj që ky amendament të renditet si amendamenti 65, në radhën e amendamenteve të mëhershme.

Njëkohësisht edhe në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” i mbështetim amendamentet e këtij projektligji dhe kërkojmë që këto amendamente dhe ky projektligj të votohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në fakt, në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 65 amendamente. Dëgjuat edhe deputetin Rexhep Selimi, në emër të Komisionit funksional. Në bazë të Rregullores ne mund të shkojmë me amendamente një nga një, por e kemi një unanimitet të Komisionit funksional për 65 amendamentet, dhe mund të shkojmë drejtpërdrejt nga 1 deri në 65, me votim në tërësi, e në fillim vetëm të amendamenteve, nëse ju jeni të pajtimit, e nëse ka kundër, le të

lajmërohen. Pra, do të shkojmë në votim. Janë 65 amendamente dhe i votojmë një herë të gjitha amendamentet, me një aprovim formal.

A ka kush kundër? Nëse s'ka kundër, votohen të 65-tat.

Atëherë, aprovohen të 65-tat.

Tash e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

I kemi 73 deputetë që kanë votuar, 69 janë për dhe 4 abstenime, prandaj Kuvendi konstaton se e miratoi Ligjin për armë.

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

E ftoj raportuesin e Komisionit FunkSIONAL, deputetin Anton Quni, që para deputetëve të paraqet dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

ANTON QUNI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin numër 05/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-246 për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore dhe ka formuar Grupin e punës për shqyrtimin e tij.

Grupi i punës e ka paraqitur raportin për diskutim në mbledhjen e Komisionit. Komisioni e ka shqyrtuar projektligjin duke e përfshirë edhe raportin e Grupit punues dhe përfundimisht i ka miratuar 4 amendamente.

Raportin me amendamente e ka proceduar te komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë sipas kompetencës.

Vlerësimi i të gjitha komisioneve relevante është për, prandaj edhe i ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë ligjin në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në fakt, në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 4 amendamente. Raportuesi i Komisionit funksional, deputeti Anton Çuni tregoi se ka unanimitet të Komisionit.

Pra, i kemi 4 amendamente, të cilat do t'i votojmë bashkërisht, me një votim formal. Nëse ka kundër, urdhëroni, e nëse jemi të gjithë për, atëherë i aprovojmë.
Pra, u votuan 4 amendamentet.

Tash e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

E kisha lutur regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

71 deputetë kanë votuar, të gjithë janë për dhe konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri.

Jemi në pikën e fundit të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014

Komisioni funksional për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj nënkryetaren e Komisionit Funksional për Legjislacion, zonjën Selvije Halimi për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate e Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në cilësinë e Komisionit funksional, duke vepruar në pajtim me nenin 72 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor dhe 6 korrik të vitit 2015 e shqyrtoi raportin e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014 dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqet këtë rekomandim:

- Të miratohet raporti i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Komisioni për Buxhet e Financa, zoti Naser Osmani nuk është këtu për ta arsyetuar raportin.

A ka ndokush që do të marrë fjalën? OK!

Nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare e kemi Agim Ademaj, të lajmëruar në mënyrë elektronike, dhe s'kemi asnjë tjetër nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Urdhëro, Agim, e ke kërkuar fjalën.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Këta po thonë për ta hedhur në votim, po e hedhim në votim, s'ka problem.

KRYETARI: Atëherë, shkojmë drejt në votim. Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin... Urdhëroni! Puhia e ka kërkuar fjalën, nga Lëvizja "Vetëvendosje"

PUHIJE DEMAKU: Faleminderit !

Unë desha të preku një anë të këtij raporti.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Ndonëse regjistrimi i mërgatës është ende në proces e sipër dhe ne nuk posedojmë shifra të sakta e kredibile, prandaj është e ditur që mërgata shqiptare përbën rreth 40% të popullsisë së tërësishme të Kosovës.

Para luftës, gjatë luftës dhe tash në paqe mërgata ka luajtur një rol të rëndësishëm ekonomik dhe politik. Sot gati gjysma e buxhetit të Republikës së Kosovës, pra 700 milionë euro në vit, vijnë nga mërgata. Fatkeqësisht dhe jo për fajin e saj, roli politik i mërgatës është reduktuar në minimum, për të mos thënë është zhdukur fare.

Megjithëse formalisht mundësia e pjesëmarrjes në zgjedhje iu njihet, praktikisht atyre u është pamundësuar pjesëmarrja. Edhe pse si proces zgjedhor është realizuar në të kaluarën, pjesëmarrja e mërgatës dhe e votuesve jashtë vendit ka qenë shumë e ulët. Mesatarisht përfshirja e mërgatës në zgjedhje nuk e ka kaluar numrin prej 1.500 votues që kanë votuar përmes postës.

Një numër i tillë është fyes për mërgatën dhe e turpshme për institucione tona, duke e pasur parasysh shtrirjen dhe madhësinë e mërgatës sonë, por edhe pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në mënyra të ndryshme në Kosovë.

Duke qenë gjithnjë falënderues ndaj mërgimtarëve që në kohë të zgjedhjeve kanë bërë shpenzim kohe dhe parash që të vijnë për të votuar në Kosovë, shifrat e votimit me postë nuk e shprehin as afërsisht vullnetin e mërgatës, por as interesimin për pjesëmarrje në zgjedhje dhe në jetën politike dhe shoqërore në përgjithësi.

Pjesëmarrja e tyre e ulët është pasojë e mungesës së vullnetit politik dhe institucional, procesit të komplikuar të votimit, mungesës së informacioneve të mjaftueshme dhe të nevojshme dhe afateve të shkurtra për regjistrim dhe votim, si dhe i mungesës së një strategjie ndër institucionale për të përfshirë mërgatën në jetën shoqërore-politike dhe veçanërisht në procesin e zgjedhjeve.

Kjo mospërputhje e theksuar dhe e papranueshme në mes të madhësisë së mërgatës sonë, kontributit politik, kombëtar dhe ekonomik dhe përfshirjes së tyre në zgjedhje, është jashtë çdo parametri dhe standardi ndërkombëtar mbi zgjedhjet.

Shumë vende, me mërgatë shumë më të vogël, pa lidhje kaq të fuqishme me vendin amë dhe me kontribut shumë më të vogël kanë një pjesëmarrje shumë më të madhe në zgjedhje të mërgatës së tyre.

Prandaj, pyetja që duhet të parashtrojmë të gjithë, është se pse kemi vetëm 1.500 votues nga mërgata dhe si mund të qëndrojmë të qetë e indiferentë kundrejt kësaj shifre turpëruese për të gjitha institucionet e Republikës, e veçanërisht për KQZ-në.

Nga të dhënat që do t'i jap më pas, dëshmohet se KQZ-ja ishte e zënë që kundërligjshëm të mundësojë votat e orkestruara dhe të falsifikuara nga Serbia që kishin për qëllim zbarkimin e Serbisë në Kuvendin e Kosovës përmes Listës Serbe.

Dhe duke e dërguar në kundërshtim me ligjin mbi zgjedhjet, ekipet e zyrtarëve që fizikisht të pranonin dhjetëra mijëra aplikacione dhe fletëvotime në Nish, gjersa votuesit nga mërgata nuk arrijnë as të informoheshin për kohën, për mënyrën dhe periudhën e votimit.

Në funksion të njëjtë dhe po ashtu në kundërshtim me Ligjin për zgjedhjet, KQZ-ja e detyruar politikisht nga Qeveria e Kosovës ka përfshirë në operacionin e votimit përmes postës dhjetëra mijëra aplikacione dhe më pas edhe mijëra fletëvotime nga Serbia, vetëm për të përmbushur synimet e Serbisë.

Kujtojmë këtu se në bazë të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, nenit 97 pika 1, thuhet qartazi:

Votuesi me të drejtë vote mund të aplikojë për të marrë një fletëvotim për votim jashtë Kosovës, duke e dorëzuar të plotësuar aplikimin për votim jashtë Kosovës apo formularin e regjistrimit të votuesit aplikim nëpërmjet postës, në formën në dispozicion nga faqja elektronike e KQZ-së, nën a) përmes postës nga një nga kutitë me zonë postale të KQZ-së ose nën b) përmes faksit në KQZ në numrin e shënuar në aplikimin për votim jashtë Kosovës, ndërkaq në bazë të rregullës së KQZ-së aplikimi mund të bëhet edhe përmes e-mail-it.

Siç e shihni, dërgimi i ekipeve fizike për të pranuar aplikacione nuk figuron në Ligin në fjalë. Rrjedhimisht, 25.263 aplikacione që u sollën nga Serbia ishin të kundërligjshme, të falsifikuara, të manipuluara dhe të fabrikuara nga Qeveria e Serbisë, me dijen dhe lejen e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Sipas raportit të KQZ-së, faqe 40, bëhet e ditur se përmjet këtyre mënyrave kanë aplikuar si në vijim: 25 përmes postës, 500 përmes faksit dhe 3.411 përmes e-mailit, ndërsa 25.263 aplikacione janë marrë direkt në Nish të Serbisë nga ekipet e KQZ-së.

Siç shihet nga po ky raport numri i përgjithshëm i aplikacioneve nga Serbia është 25.433, nga 29.745 që kanë qenë gjithsej, prandaj ky operacion më saktë mund të quhet operacioni i votimit të Serbisë se sa operacioni i votimit nëpërmjet postës për zgjedhjet në Kosovë.

Vetëm në dy palë zgjedhjet e fundit kur ndërhyrja politike i kishte karakterizuar zgjedhjet. I kemi këtu të dhënat të regjistrimit si votues jashtë vendit.

Për zgjedhjet e vitit 2013 nga gjithsej 21 168 aplikacione, prej tyre 38 228 janë nga Serbia, ndërsa vetëm 2 940 nga mërgata, apo shprehur në përqindje 92,85% janë nga Serbia, e të tjerat janë nga mërgata.

Në vitin 2014 në zgjedhje, nga gjithsej 29.745 aplikacione, prej tyre 25 433 janë nga Serbia apo 85% e totalit të aplikacionit për votim jashtë vendit, e të tjerat nga mërgata.

Këto janë shifra skandaloze. Nëse Serbia paska më shumë interesim për të marrë pjesë në zgjedhjet në Kosovë se sa që ka interesim mërgata jonë, po shihet qartë se cilës palë Qeveria e Kosovës po ia bën hyzmetin e cilës palë po ia cenon të drejtat kushtetuese.

Ne konsiderojmë se pjesëmarrja e mërgatës në zgjedhje duhet të stimulohet, posaçërisht duke e thjeshtuar procesin e regjistrimit dhe atë të votimit. Përgjithësisht regjistrimi i votuesve nga mërgata duhet të jetë më fleksibil në kuptimin e mënyrave të aplikimit. Përveç aplikimit përmes postës, e-mailit dhe faksit, atyre duhet t'u mundësohet regjistrimi on-line duke plotësuar një aplikacion dhe dërguar përmes internetit.

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Nuk mjafton që mërgatën ta presim me billborde, me bakllava apo me organizimet që i quajmë “ditët e mërgatës” e as duke i hapur vetëm formalisht dyert e këtij Kuvendi për vizitën për ta, por duke iu afruar dhe garantuar të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Faleminderit !

KRYETARI: Faleminderit! Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Ne vërejtjet tona i kemi dhënë edhe në Komisionin parlamentar gjatë shqyrtimit të këtij raporti në Komisionin për Legjislacion dhe po e përsëris prapë se vërejtjet tona janë mospastrimi i listave ose pastrimi i pjesshëm i listave, sepse këto gjëra në fakt po përsëriten prej vitit në vit.

Nuk kemi numër të saktë të votuesve, ndërsa mos përfshirja e diasporës dhe moskrijimi i kushteve për të votuar në diasporë, është një gjë e papranueshme sepse është e pakuptimshme, duke llogaritur numrin e njerëzve tanë që jetojnë në diasporë dhe me numrin e votuesve 1 500 që është shumë e papranueshme dhe kërkojmë që në zgjedhjet e ardhshme t'u krijohen kushte dhe mundësi që edhe diaspora jonë të votojë dhe të mos jetë një numër i tillë në disproporcion me numrin e njerëzve që jetojnë në diasporë dhe me numrin e njerëzve që kanë votuar, andaj edhe diasporën duhet ta trajtojmë ashtu siç e meriton.

Për këtë arsye dhe për arsye të tjera, ne nuk do ta votojmë këtë raport.

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Organizimi i zgjedhjeve të përgjithshme por edhe i zgjedhjeve lokale të vitit 2013 është dashur që të kenë piksynim përmbushjen e zgjedhjeve të lira dhe me integritet, sanimin apo eliminimin e defekteve të identifikuar nga zgjedhjet e kaluara dhe pjesëmarrjen sa më masive të qytetarëve që jetojnë në Kosovë dhe të mërgatës për të cilën foli deputetja Puhije Demaku.

Edhe përkundër vjedhjeve industriale të vitit 2010, debateve politike e shoqërore, për nevojën e ndryshimit të praktikës dhe mënyrës së administrimit të zgjedhjeve, edhe zgjedhjet e 3 nëntorit,

pra ato lokale dhe ato të 8 qershorit u zhvilluan brenda të njëjtës kornizë organizative dhe më tepër ishin një kamuflim i sofistikuar i implementimit të marrëveshjes së prillit, pra të 19 prillit me Serbinë, themelimit të “Zajednicës” dhe akomodimin e zërit të Serbisë në Kuvendin e Kosovës përmes Listës Serbe, se sa përpjekje për përkthim të vullnetit të qytetarëve në mënyrë të drejtë dhe të painstrumentalizuar.

Për më tepër, një gjë e tillë u bë në të shumtën e rasteve përmes shkeljes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ligjeve të aplikueshme.

Sikurse në vitin 2013, po ashtu edhe në vitin 2014 raportin e të cilit vit po e shqyrtojmë, KQZ-ja toleroi aranzhmane të veçanta dhe paralele për kërkesat e Serbisë që nga përfshirja e mbi 10 mijë personave pa qenë fare shtetas të Republikës së Kosovës në listën e votuesve, megjithëse me Kushtetutën dhe Ligin për zgjedhjet në Republikën e Kosovës të drejtë vote në Kosovë kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës, të regjistruar në regjistrin qendror civil, sipas Ligjit mbi shtetësinë, si që edhe 25.263 aplikacione janë marrë direkt në Nish të Serbisë nga ekipet e KQZ-së.

E tërë kjo kishte ndodhur përveç vendimeve politike dhe dakordimeve gjatë dialogut politik me Serbinë dhe në shërbim të synimeve dhe të interesave të Serbisë për të rritur artificialisht numrin e votuesve dhe për të kompensuar mungesën e vendeve të rezervuara, si dhe të përzgjidhte direkt se kush do të ishin deputetët e pakicës serbe në Kuvend.

Integriteti i zgjedhjeve nuk nënkupton vetëm largimin e duarve të manipuluesve nga kutitë e votimit, por edhe krijimin e kushteve për zgjedhje të lira dhe të barabarta edhe jashtë vendvotimeve.

Në këtë drejtim, këto zgjedhje, duke e përfshirë edhe periudhën para se të shpallehin ato, janë të karakterizuara më shumë se asnjëherë më parë me shfrytëzimin e resurseve publike e institucionale nga partia në pushtet aso kohe, në funksion të blerjes së votës në mënyrë indirekte, duke devijuar kështu vullnetin e votuesve përmes abuzimit me resurset shtetërore.

Përdorimi i shërbyesve civilë në kampanja, shfrytëzimi i pasurisë shtetërore, punësimet pa konkurse në administratë e keqpërdorimi i verifikimit të veteranëve dhe kategorive të dala nga lufta, ishin vetëm disa nga veprimet e partisë shtet, e cila vetëm disa javë para ditës së zgjedhjeve i kishte ndërmarrë nga zyrat e Qeverisë.

Edhe në këto zgjedhje, numri i fletëvotimeve të pavlefshme ka qenë mjaft i madh dhe sigurisht që kjo mbetet shqetësuese. Nga të dhënat zyrtare, diku rreth 40 mijë fletëvotime janë shpallur si të pavlefshme. Rrjedhimisht, mbi 5% të votuesve, u është mohuar vullneti qytetar. Natyrisht që informimi i pamjaftueshëm i votuesve dhe trajnimi jo adekuat i komisionarëve, kanë ndikuar sërish në rritjen e numrit të fletëvotimeve të pavlefshme.

Po ashtu, KQZ-ja në kundërshtim me Kushtetutën dhe jashtë përgjegjësi të saj, kishte kërkuar nga OSBE-ja që të marrë rolin e organizimit të zgjedhjeve në katër komunat veriore. Një rol të tillë OSBE-ja e kishte edhe në zgjedhjet e kaluara lokale, por për zgjedhjet e përgjithshme ka degraduar deri në marrjen e këtyre përgjegjësiwe operacionale dhe ekzekutive, pa kurrfarë baze ligjore apo pa kurrfarë marrëveshjeje të veçantë.

Çështja nuk është se KQZ-ja nuk ishte në gjendje që t'i organizojë zgjedhjet në pjesën veriore, porse serbët refuzonin të marrin pjesë në zgjedhjet të cilat organizoheshin nga KQZ-ja dhe institucionet e Republikës së Kosovës. Serbia kërkonte që zgjedhjet në hapësirën e veprimit të “Zajednices” të mos organizohen nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe kështu së paku të sigurohej neutraliteti i pjesës veriore.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk mund ta votojë këtë raport, sepse çështjet që i karakterizuan zgjedhjet e fundit ishin: zbatimi i marrëveshjes së dëmshme me Serbinë, akomodimi i kërkesave të Serbisë, legjitimimi i strukturave paralele, votimi me dokumente të Serbisë dhe vetëm mbi bazën e shtetësisë së Serbisë, sjelljen e dhjetëra mijëra aplikacioneve të organizuara dhe të plotësuara nga makineria shtetërore e Serbisë, vendosja e bazave për konstituivim të “Zajednices”, heqja dorë nga organizimi shtetëror i zgjedhjeve në veri, e deri te legjitimimi i transformimit të strukturave paralele në një subjekt politik, siç është Lista Serbe, e cila, pa verifikimin minimal ligjor dhe politik për kandidatët dhe programin e saj nga ana e KQZ-së, përmes një procesi po aq paralel e të paligjshëm të sjelljes së votimeve të falsifikuara nga Serbia, arriti që të vijë deri këtu, duke i kaluar një sërë fazash, të gjitha këto sipas kushteve dhe kërkesave të tyre, gjersa institucionet vendore symbyllazi toleruan ngritjen e saj dhe po e legjitimojnë përditë si një Serbi në miniaturë përbrenda institucioneve dhe Republikës në përgjithësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë,

Raporti i KQZ-së si dhe raporti i Qeverisë dhe të disa mekanizmave ndërkombëtarë i kanë shpallur zgjedhjet e 2014 si zgjedhje të mira dhe të rregullta të Republikës së Kosovës, por në brendësi nënkuptohen se ka shumë gjëra që duhet të ndryshohen nga Komisioni Zgjedhor.

Komisioni Zgjedhor nuk është azhur në pastrimin e listave të votuesve, i cili bëhet në bashkëpunim me ARC-në, për të hequr prej listave të votuesve emrat e njerëzve që nuk jetojnë më. Kjo realisht ndodh që vetëm të shtohen votuesit e rinj, e asnjëherë të hiqen emrat e njerëzve që nuk jetojnë, e kjo normal që ndodh për t'u keqpërdorur nga organizatori i zgjedhjeve, që në këtë rast është Qeveria.

Nga raportet tjera të mekanizmave të BE-së thuhet se është një numër shumë i madh i fletëvotimeve të pavlefshme, a është çështja e mosinformimit të votuesve për procedurat e votimit apo është fjala për dëmtimin e fletëvotimeve në proceset zgjedhore, apo Qeveria e cila është përgjegjëse për propozimin e zgjedhjeve krijon kësi lloj mundësie për të manipuluar. Kjo çështje i bie Komisionit Qendror Zgjedhor që të merren me këto parregullsi dhe të jetë i drejtë e të mos ketë shkelje gjatë proceseve zgjedhore.

Nga të gjitha të gjeturat e këtij raporti, kërkohet nga KQZ-ja që të evidentojë këto gabime dhe të bëjë organizime të drejta të zgjedhjeve në tërë territorin e Kosovës, përfshirë edhe veriun e Kosovës, e jo t'i organizon zgjedhjet OSBE-a atje, po ajo të jetë në rolin e mbikëqyrjes së

zgjedhjeve dhe njëkohësisht të respektohen qytetarët e kësaj pjese të Republikës së Kosovës dhe të jenë me dokumente të Republikës sonë.

Njëkohësisht kërkoj nga partitë politike që të ulen dhe të krijojnë Ligjin për zgjedhjet dhe të krijojnë një sistem të mirëfilltë të procesit zgjedhor të drejtë dhe të besueshëm për qytetarët tanë.

Grupi i Nismës nuk do ta votojë këtë raport, sepse në këtë raport kemi vetëm mrekullia të raportuara gjatë përpilimit të këtij raporti, dhe nuk i kanë evidentuar të gjeturat të cilat në raportet e BE-së shihen shumë qartë rreth proceseve zgjedhore në Kosovë. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa e ka fjalën dhe të përgatitemi për votim, nëse nuk ka tjerë deputetë për të diskutuar.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk e pata ndërmend të flas por ne sot jemi duke diskutuar për miratimin e raportin vjetor të KQZ-së për vitin 2014 dhe është e vërtetë se ka shumë shqetësime, janë shqetësim edhe pjesëmarrja e vogël e votuesve në diasporë, është shqetësim pastrimi i listave në shumë komuna dhe më i madh është numri i votuesve se sa numri i banorëve, ka edhe shqetësime tjera, por unë konsideroj se në këtë rast nuk është temë kjo të diskutohet nga deputetët, por ne jemi duke diskutuar jo për organizimin e zgjedhjeve, por për aprovimin e raportit. Deputetët duhet të flasin për raportin konkret dhe nëse kanë argumente t'i afrojnë edhe me shkrim.

KQZ-ja duhet t'i ketë parasysh shqetësimet të cilat kanë qenë të qytetarëve në organizimin e zgjedhjeve të reja kur do të jenë ato lokale dhe qendrore dhe nëse kemi mangësi ligjore ne si deputetë kemi mandatin dhe duhet të bëjmë plotësim-ndryshimin e ligjeve për zgjedhje që t'ua lehtësojmë edhe votuesve tanë në diasporë dhe ta kenë më lehtë të votojnë dhe jo të ndalemi në raport.

Unë konsideroj se jemi bërë pak konfuz kur flasim se si duhet të organizohen zgjedhjet dhe jo për raportin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Puhije, për replikë? Urdhëro!

PUHIJE DEMA KU: Desha vetëm t'ia kujtoj zotit Beqa, që raportet vjetore hartohen në bazë të punës që është bërë, pra në bazë të një organizimi të një procesi zgjedhor i cili ka qenë shqetësues dhe raporti reflekton po të njëjtat shqetësime, madje-madje na ofron fakte për t'i ngritur këto shqetësime dhe në Kuvend.

Për më tepër, t'ju kujtoj edhe një herë se zgjedhjet e vitit 2013 dhe 2014 ua ka shpallur Daçiçi, e jo Republika e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Hajdar, kundër-replikë.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

E nderuara deputete,

Unë nuk e përmenda emrin e juaj, por megjithatë konsideroj dhe prapë qëndroj prapa asaj, se edhe deklaramet tuaja, të akuzave dhe të tjera në foltore është mirë të jenë të argumentuara me shkrim.

Unë e kam të qartë për çka po flasim. Po flasim për një raport pune dhe ju si deputete është mirë para organizimit të zgjedhjeve të jepni kontributin tuaj, dhe nëse ka mangësi ligjore ta jepni kontributin apo të kërkon plotësim-ndryshimin e ligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ! Puhija edhe një herë, sepse je opozitë. Urdhëro!

PUHIJE DEMAKU: Patjetër, dhe do t'ua jap me shkrim fjalimin që sa po e mbajta në Kuvend dhe e kam të shkruar, të gjitha janë me fakte nga raporti i KQZ-së.

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e raportit vjetor të punës të Komisionit Qendror Zgjedhor për vitin 2014.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 68 deputetë, 49 janë për, 18 kundër dhe 1 abstenim.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014.

Me këtë i mbyllem punimet e seancës plenare. Faleminderit dhe fundjavë të mirë!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*